Seksioni i muzikës-Seksioni i muzikës do realizon pjesë të rëndësishme nga jeta kulturo-artistike në shkollë. Realizimi i programit të seksionit të muzikës do jetë nëpërmjet aktivitetit të korit të shkollës, solo-këngëtarëve, duetëve, grupeve kënduese, vallëzimit modern dhe të ngjajshme. Seksioni i muzikës me paraqitjen e vet do çfaqet në raste të ndryshme siç është dita e patronatit të shkollës, dita e arsimit, mbarimi i vitit shkollor dhe të ngjajshme.Realizator: **Ganimete Ilasi, Nehat Ibrahimi dhe Sherif Mustafa.**

Seksioni i artit figurative-Interesimi për artin figurativ do vij në shprehje në programin e artit figurativ.Për nxënësit që tregojnë interesim dhe afinitet për artin figurativ do ju ndihmohet që të perfeksionojnë talentin e tyre. Prezentimi do jetë nëpërmjet organizimit të ekspozitave dhe prezenteve të tjera. Realizator: Verim Zendeli dhe Mirsad Osmani

Aktivitetet sportive-Programi për aktivitetet sportive do të realizohet në pajtim me kushtet e sportimit. Prej aktiviteteve do të realizohen seksionet në vijim: I futbollit,basketbollit, Volejbollit ,shah,ping pong dhe atletikës. Aktivitetet e lira të shprehura nëpërmjet sportit dhe artit kanë rëndësi shumë të madhe për shkak kushteve specifike të punës së shkollës . Me anë të aktivitetit fizike dhe me ate edhe prej ngjarjeve sportive, duhet që të plotësojnë atë shprehje, këtu duhet që të këmbëngulet që të vjen një bashkëpunim i madh me mjedisin lokal, gjersa shkolla duhet të jetë bartëse e jetës kulturore.Në programet e këtyre seksioneve vend të rëndësishëm duhet të gjej funksioni edukativ, humaniteti dhe përforsimi i patriotizmit të ri. Realizator arsimtarët e edukatës fizike dhe të arsimit shëndetësor

9.3. Aksioneshkollore

Ky lloj i aktiviteteve jashtëshkollore përfshin:

Aksionet për rregullimin e hapësirës në klasë dhe ndërtesës shkollore me qëllim që të krijohet pamje estetike dhe ambient për punë, të krijohen shprehi për:

-Mirëmbajtjen e higjienës, ruajtjen e pronës dhe zhvillim të përgjegjshmërisë.

-Mirëmbajtje e terreneve sportive dhe gjelbërimit në oborr.

-Organizim i aksioneve për grumbullimin e ushqimeve dhe rrobave.

-Organizimi i shfaqjeve, manifestimeve dhe ngjarjeve me karakter humanitar.

-Aksion për dhurimin e librave në institucionione tjera.

-Bashkëpunim me Kryqin e kuq të komunës së Gostivari

10. Organizimi dhe pjesëmarrja e nxënësve

Nëpërmjet të funksionimit të trupave të nxënësve kanë mundësi që demokratikisht të marrin pjesë në shqyrtimin, miratimin e të gjitha pyetjet rreth jetës shkollore. Mësojnë të kenë vetëbesim dhe një fotografi pozitive për vetëveten, ta shprehin mendimin e tyre si dhe ta respektojnë mendimin e tjetrit, të marrin akcione dhe të bëjnë ndryshime dhe të sjellin vendime. Nëpërmjet të funksionimit të Parlamentit të nxënësve përparon procesi i nxënjes në marrjen e iniciativës dhe aktivizimin e tyre. Në fillim të vitit shkollor anëtarët e Parlamentit të nxënësve delegohen nga bashkësia e klasës . Deri në zgjedhje të kryetarit të rri të parlamentit të nxënësve për vitin shkollor 2024/25, kryetardo të bëhet në shtator dhe , zgjedhja e avokatit të nxënësve do të bëhet në muajin shtator , sepse vitin e kaluar u zgjodh nxënës i klasës së nëntë.

Përmbajtja /qëllimet:

Formimi i Parlamentit të nxënësve ;

Përpilimi i Programit për punë;

Përcaktimi i prioriteteve dhe veprimi ;

Përpilimi i planeve për iniciativë dhe realizim të tyre;

Vlerësimi dhe promovimi i rezultateve të arritura

PROGRAMI VJETOR PËR PUNËN E PARLAMENTIT TË NXËNËSVE SHFK"NAIM FRASHERI"-NEGOTINË

Puna e Parlamentit të Nxënësve të shkollës ndihmohet dhe mbështetet nga drejtori, pedagogi, psikologu, bashkëpunëtorët profesional, edukator special, si dhe të gjithë mësimdhënësit.

Përmbajtja	Qëllimet/rezultatet e pritshme	muaj	Bartësit e aktivitetit
Grupim	Ndjenja e përkatësisë, kolektiviteti	IX	Përgjegjës: mësues -nxënës
Zgjedgja e udhëheqësis	Objektiviteti, kolektiviteti	IX	Përgjegjës- Mësues, nxënës pedagog, psikolog
Rëndësia e parlamentit të shkollës dhe zgjedhja e organeve të tjera drejtuese	Aritja e përfitimeve edukative për zhvillimin e parimeve	IX	Përgjegjës- mësues, nxënës pedagog, psikolog
I.Fusha Fusha 1.1., Komunikimi verbal dhe jo verbal"	Organizimi i komunikimit verbal dhe joverbal Komunikimi ,aritje në përfundim	X	Përgjegjës- mësues, nxënës pedagog, psikolog Përgjegjës- mësues, nxënës pedagog, psikolog
II.Fusha 2.1., Udhëheqës" 2.2., Udhëheqësi në mua"	Karakteristikat e udhëheqjes, Udhëheqësi në mua, duke aritur një përfundim.	XI	Përgjegjës mësues-nxënës, pedagogë-psikolog,

	Njohja e aftësive personale udhëheqëse		
II.Fusha 2.1,,Udhëheqës” 2.2.,, Udhëheqësi në mua”	Karakteristikat e udhëheqjes, Udhëheqësi në mua, duke aritur një përfundim. Njohja e aftësive personale udhëheqëse	XI	Përgjegjës mësues-nxënës, pedagogë-psikolog,
III.Fusha 3.1 „Puna ekipore” 3.2,,Eko-aktivitete”	Elementet bazë të punës në grup, përmirësimi i punës në grup, aritja e një përfundimi. Elementet bazë të punës në grup, përmirësimi i punës në grup, kujdesi për mjedisin në të cilin ndodhemi (shkolla), aritja e një përfundimi	XII	Mësues përgjegjës, shërbim profesional, studentë Mësues përgjegjës, mësues përgjegjës për ECO, nxënës, studentë me NVE dhe bashkëpunëtorë profesionistë, mësues të arsimit special
IV.Fusha 4.1, Bullizëm”	Çfarë është bullizmi, format e tij, ku të drejtoheni për ndihmë.	I	Përgjegjës, mësues.shërbim profesional, nxënës
V.Fusha 5.1,, Debat i për një temë të caktuar”	Çfarë është një debat, format e debatit, si organizohet një debat, përfundimi	II	Përgjegjës drejtor,mësues.shërbim profesional, nxënës

VI.Fusha 6.1.,Kam të drejtë të di të drejtat e mia” 6.2.,Kam të drejtë por kam dhe përgjegjësi”	Vendimi im, vendimi juaj.reflektim i puntoris përfundimtare	III	Përgjegjës,mësues.shërbim profesional, nxënës
VII.Fusha 7.1 ,, Konventa për të Drejtat e Fëmijës” 7.2,, Gjetja në një grup”	Njohja me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, përfshirja e fëmijëve me NVE. Të gjithë duhet të gjenden në një grup të caktuar	IV	Përgjegjës, mësues nxënës, nxënës nga PN, shërbimi profesional, bashkëpunëtor profesional, fëmijë me NVA.
VIII.Fusha 8.1,,Arsimimi im, e ardhmja ime,, 8.2,,Arsimimi ndërkulturor,,	Qëndrimet e veta, mendimet, idetë për arsimim dhe të ardhmen, aktivitetet ndëretnike	V	Përgjegjës drejtor, mësues ,nxënës Mësues të Përgjegjës mësues shërbim, profesional,nxënës.
Raport i punës së PN-sve	Sjellja e pikëpamjeve dhe ideve të veta në punën e PN-sve	VI	Mësues të Përgjegjës mësues shërbim, profesional,nxënës.

11. Aktivitetet jashtëshkollore

11.1. Ekskursionet, shëtitje dhe mësim në natyrë

Sipas Rregullores së MASH-it shkolla jonë ka përgatitur një plan për realizimin e ekskursioneve, mësimin në natyrë dhe shëtitjeve për vitin shkollor 2024/2025

Ekipi profesional përPërgatitjen eProgramit :

Drejtori: Afërdita Hoda

Nd.Drejtori: Rabi Ismaili

Pedagog. Ferdane Velija 1. Hyrje

2.Programë për realizimin e shëtitjes pranverore në rrethin më të afërt për nxënësit e klasës së parë, të dytë, të katërt dhe të pesta.

3. Programë për realizimin e shëtitjes pranverore në rrethin më të afërt për nxënësit e klasës së shtatë dhe të tetë.

4.Programë për realizimin e ekskursionit një ditë me nxënësit e klasëve të treta.

5. Programë për realizimin e ekskursionit dy ditë me nxënësit e klasëve të gjashtë.

6. Programë për realizimin e ekskursionit tre ditë me nxënësit e klasëve të nënta

7. Programë për realizimi e mësimin në natyrë

Në përputhje me Programin Vjetor të Punës së shkollës, si dhe Rregulloren për mënyrën e realizimi e ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve të tjera të lira të nxënësve në shkollën fillore, Ekipi Profesional miratoi një Programë për

realizimin e ekskursioneve të nxënësve dhe aktivitete të tjera të lira për vitin shkollor 2024/25.

Në program përfshihen:

1. Qëllimet edukativo-arsimore,

2. Detyrat;

3. Përmbajtja e aktiviteteve;

4. Udhëheqësi, mësuesit, nxënësit;

5. Kohëzgjatja;

6. Vizita e vendeve dhe udhëzimet për udhëtim

7. Organizimi teknik, dhe

8. Mënyra e finansimit

Për pregaditjen profesionale- pedagogjike ,për organizimin teknik dhe karakterin e sigurimit si dhe realizimin e ekskurzioneve dhe aktiviteteve të tjera të lira në shkollë kujdeset ekipin profesional I formuara me Vendimin e Këshillit të Shkollës.

Sipas Rregullores pas marrjes së pëlqimit për realizimin e ekskurzionit nga Këshilli i Prindërve, BZHA dhe Këshilli i Komunal , programa prezentohet para Këshillit të Shkollës i cili jep pëlqimin e tij dhe ka pasqyrë të plotë për organizimin, zgjedhjen e agjencionit dhe realizimin e ekskursionit. Nxënësit që nuk do të marrin pjesë në ekskurzion, në përputhje me Rregulloren, shkolla do të organizojë mësimi për ta.

PROGRAMË PËR REALIZIMIN E SHËTITJEVE PRANVEROR NË RRETHIN MË TË AFËRT TË DEDIKUAR PËR NXËNËSIT E KLASAVE I, II, IV dhe V

1. Qëllimet edukativo- arsimore:

- Zotrimi, zgjerimi i njohurive, zbatimi i aftësive dhe qëndrimeve përmes njohjes direkte me fenomenet dhe marrëdhëniet në mjedisin natyror dhe shoqëror, në përputhje me punën edukative-arsimore të shkollës.

2. Detyrat:

- Njohja e nxënësve me florën dhe faunën e Malit Shar.

- Njohja direkte e nxënësve me bukuritë e Malit Shar dhe përfitimet e tij për njerëzit dhe zhvillimin e turizmit

- Të rritet ndërgjegjësimi i nxënësve për ekzistencën e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e tyre;

- Të zhvillohet dhe kultivohet shprehjet kulturore të sjelljes në grup gjatë vizitave të objekteve.

3. Përmbajtja dhe aktivitetet:

- Bërja e vizatimit, florës dhe faunës

- Diskutim për malin Shar

4. Udhëheqësi i shëtitjesë, mësuesit dhe nxënësit:

- Udhëheqësi i shëtitjesë Rabi Ismaili ,Fetnet Adii ,Mirzana Jaja , Ilvana Halili ,Mirlinda Muharemi

5. Kohëzgjatja: një ditë pune Koha e realizimit: maji-qeshorë 2025.

6.Vendet për vizitë dhe marshuta e udhëtimit

-Relacioni: Negotinë - burimi natyror Uji i Tharët - Negotinë

7. Organizimi teknik: Do të kryhet në përputhje me Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskurzioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lirë të nxënësve të shkollës fillore. Komisioni shkollor për realizimin e ekskurzioneve dhe aktivitete tjera të lirë do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për realizimin e të njëjtës.

8. Mënyra e financimit: Shëtitjet e nxënësve financohen nga prindërit e nxënësve në tërësi.

PROGRAMË PËR REALIZIMIN E SHËTITJEVE NJË DITORE PRANVERORE NË RRETHIN MË TË AFËRT PËR NXËNËSIT E KLASAVE VI , VII , VIII DHE IX

1. Qëllimet edukativo-arsimore:

2.Përvetësimi, zgjerimi i njohurive, zbatimi i aftësive dhe qëndrimeve përmes njohjes direkte të fenomeneve, si dhe marrëdhënieve në mjedisin natyror dhe shoqëror, në përputhje me punën edukative-arsimor të shkollës.

3. Detyrat: Njohja e nxënësve me florën dhe faunën e Malit Shar

-Njohja direkte e nxënësve me bukuritë e Malit Shar, përfitimet e tij për njerëzit dhe zhvillimin e turizmit- Të rritet ndërgjegjësimi i nxënësve për ekzistencën e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e tyre;

4.Përmbajtja dhe aktivitetet:

-Përgaditja e vizatimit të florës dhe faunës

-Diskutim mbi malin Shar

-Udhëheqësi i shëtitjesë, mësuesit dhe nxënësë

5. Kohëzgjatja: një ditë

Koha e realizimit: gjysma e parë e majit 2025 .

6. Vendi për vizitë dhe drejtimet tjera për udhëtim: Negotino –Mavrov - Negotino

7. Organizimi teknik:

Mënyrën e realizimit do të kryhet në përputhje me bëhet me një autobus modern që plotëson standardet e kërkuara.

8. Mënyra e financimit: Ekskursionet e nxënësve financohen tërësisht nga prindërit e nxënësve.

Rregulloren e ekskurzimeve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve në shkollën fillore.

PROGRAMË PËR REALIZIMIN E EKSURZIONIT TË NXËNËSVE TË KLASAVE III

1. Qëllimet edukativo- arsimore:

- Të zgjerojnë njohuritë për fshatin-qytet;
- Të identifikojnë dhe emërtojnë objektet më të rëndësishme në mjedis dhe ti orientojnë ato në përputhje me rrethanat;
- Të zgjerojnë njohuritë për trafikun dhe mjetet e transportit, lidhjen e trafikut në pjesë të ndryshme të rajonit të saj dhe më gjerë;
- Të zgjerojnë njohuritë për bukuritë natyrore në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Njohja me kulturën dhe mënyrën e jetesës së njerëzve në rajone të ndryshme;
- Zhvillimi i interesit për natyrën dhe ndërtimi i shprehive ekologjike;
- Zhvillimi i një qëndrimi pozitiv ndaj vlerave kombëtare, kulturore dhe estetike;
- Të aftësohet në shoqërimin dhe komunikimin të përbashkët.

2. Detyrat: - Mësimi dhe Hulumtimi i objekteve dhe fenomeneve në natyrë, si dhe marrëdhëniet në jetën shoqërore;

- Zhvillimi i interesit për natyrën dhe ndërtimi i shprehive ekologjike;
- Njohja me kulturën dhe mënyrën e jetesës së njerëzve në rajone të ndryshme;
- Ndërtimi i ndjenjës së patriotizmit, tolerancës dhe bashkëjetesës;
- Zhvillimi i një qëndrimi pozitiv ndaj: vlerave kombëtare, kulturore dhe estetike;
- Inkurajimi dhe shfaqja e emocioneve pozitive;
- Socializimi, mbrojtja kolektive dhe përvoja e përfitimit të pavarësimit dhe vetë-kujdesit;
- Rekreacioni dhe krijimi i shprehive për jetë të shëndetshme.

3. Përmbajtja e aktiviteteve:

Në kuadër të këtij ekskurzioni mësimor, do të diskutohe.

5. Kohëzgjatja: një ditëm,Koha e realizimit: gjysma e parë e majit 2025.

6. Vendet për vizit dhe drejtimet tjera të udhëtimit:Negotinë-Shkup-Negotinë

-Vizita e Muzeut te Shkupit,Vizita e Kopshtit Zoologjik ,Vizita e Kuvendit

PROGRAMË PËR REALIZIMIN E EKSURZIONIT TË NXËNËSVE TË KLASAVE TË VI-TA

1.Qëllimet edukativo-arsimore:

- zgjerimi i njohurive për më shumë lëndë mësimore;
- zbatimi i aftësive dhe qëndrimeve përmes njohjes direkte me mjedisin shoqëror dhe vendet kulturore dhe historike, kapacitetet industriale dhe të tjera.
- Të ritet dashuria për atdheun;
- të ritet respekt për traditat kulturore, pamjet kulturore dhe historike të bukurisë natyrore dhe të rrallë.

2.detyrat:

- Mësimi dhe hulumtimi i objekteve dhe fenomeneve në natyrë dhe marrëdhëniet në jetën shoqërore;
- të zbulojm dhe kuptojm marrëdhëniet në jetën shoqërore;
- ndërtimin e ndjenjës së patriotizmit, tolerances dhe bashkëjetesës;
- Përvetësimi i aftësive shoqërore;
- socializimi, mbrojtja kolektive dhe përfitimi I përvojës së kujdesit për veten;
- të krijoj shprehi miqësore për mjedisin;
- ndërtimin e një qëndrimi pozitiv ndaj natyrës dhe mjedisit njerëzor;

3.Udhëheqës, mësuesit, nxënësit: Arsimtari përgjegjës

4.Kohëzgjatja: 2 (dy) ditë.

Koha e realizimit: maji-qershor 2025

Vendet për vizitë dhe drejtimet e udhëtimit,

5.përmbajtjen dhe aktivitetet:

Dita e parë: Vizitë _____;

Përmbajtja dhe aktivitetet:

-Vizitë _____

-Vizitë. _____

-Pas vizitave të planifikuara, nxënësit do të kenë darkë dhe fjetje në qytetin e **Oherit**, pas mungjesit të nesërmen ata nisen për në **Manastirë**.

-Dita e tretë:**Manastir** .

-Përmbajtja dhe aktivitetet:

- Vizitë në _____

-Viziti e vendit _____

-Pas vizitave të planifikuara, nxënësit shkojnë në shtëpi.

6.Organizimi teknik:

-Do të kryhet në përputhje me Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskurzioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të nxënësve për shkollën fillore.

-Komisioni shkollor për ekskurzione dhe aktivitete të tjera të lirë do të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për zbatimin e tij.

-Udhëtimi do të bëhet me një autobus modern që plotëson standardet e kërkuara.

7.Mënyra e financimit: Ekskurzioni financohet nga prindërit.

-

11.2. Të dhëna për nxënësit e shkollave fillore të përfshirë në aktivitete jashtëshkollore.

Pas mbarimit të orëve mësimore, nxënësit kanë mundësinë të përfshihen në aktivitete jashtëshkollore të ofruara nga shkollat e gjuhëve të huaja, klubet sportive. Nxënësit gjithashtu përfshihen në aktivitete të ndryshme jashtë shkollës

Në fillim të vitit shkollor është planifikuar të mblidhen të dhëna për numrin e nxënësve për klasë që ndjekin aktivitete të tilla.

12. Gara për nxënësit

Garat e nxënësve në shkollën tonë kanë rëndësi parësore,sepse para së gjithash duam që nxënësit tonë të arrijnë dituri që vijnë në shprehje kur ata garojnë me nxënës tjerë të shkollave tjera.Garat e nxënësve përfshijnë aktivitete nëpërmjet së cilave nxënësit i paraqesin të arriturat e tyre në mësim dhe në lëmi tjera të veprimtarisë edukativo-arsimore dhe e përfaqësojnë shkollën në

mjedisin e vet lokal,qytetin,Republikën,por edhe në nivel ndërkombëtar.Këtu duhet të theksojmë seksionin e matematikanëve dhe pas krijimit të biznes-planit me të cilën edhe shkolla jonë ka arritur rezultate të lakmueshme.

Arsimtarët gjatë tërë vitit shkollorë në vazhdimësi marrin pjesë në të gjitha garat e mundëshme,jo vetëm në komunën e Gostivarit por edhe më gjërë.Nxënësit kanë bashkëpunim,dhe që rezulton me shpërblime të shumta.Garat do të organizohen me qëllim që nxënësit ta zhvillojnë shpirtin garues,të zhvillohet përpjekje për arritjen e vlerave më të mëdha në kulturë,art dhe sport.Nëpërmjet tyre zhvillohet dhe thellohet interesi i nxënësve dhe vendoset një mardhënie aktive ndaj mësimi,zgjerohen bazat programore,thellohen dhe pasurohen dituritë.

Nxënësit për gara do të përgaditen në orët e mësimi shtues dhe në aktivitetet e lira të nxënësve.Arsimtarët do u japin ndihmë nxënësve gjatë zgjedhjes së literaturës dhe kontrollimit të diturive.Për zgjedhjen e nxënësve për gara duhet të organizohen gara në mes individëve në kuadër të klasës ose në mes ekipeve në nivel të klasës.Nxënësit e zgjedhur shkojnë në gara më të larta.

Gjatë organizimit dhe pjesëmarrjen nëpër gara në shkollë respektohen rregullat e parapara për atë qëllim:

1. Shërbimi i shkollës në kohë shfaq planin në tabelën e informimit sipas të cilës do të realizohen garat shkollore
2. Garë shkollore e organizon ekipi së paku nga tri arsimtarë, prej ku njëri është përgjegjës me programin vjetore të shkollës.
3. Dy ditë para mbajtjes së garës sipas lëndës së paraparë vijon lajmërimi i cili do të lexohet në të gjitha paralelet dhe do të përmban informatë të plotë për të gjithë nxënësit
4. Rezultatet e garës së zhvilluar personat përgjegjës duhet ti shfaqin në tabelë për informim një javë pas garës(ndeshjes)
5. Gojarisht informohen të gjithë pjesëmarrësit e garës
6. Ekipi formon proces verbal nga gara shkollore dhe raport për rezultatet
7. Nxënësi ka të drejtë të paraqitet dhe të marrë pjesë së paku në dy gara shkollore, gjegjësisht vetëm në dy lëndë mësimore
8. Ndonëse nxënës i njëjtë fiton vendin e parë në dy gara atëherë mundet të merë pjesë në të dyja gara komunale, shtetërore sipas vet dëshirës së tij nëse ka terminë të përshtatshme.
9. . Në garat komunale/shtetërore/rajonale mundet të merë pjesë dhe fituesi i vendit të dytë në qoftë se i pari tërhiqet për shkaqe të arsyeshme.
10. Nxënësi rregullisht duhet ti vijon orët përgatitore që mban arsimtari-mentori si dhe ti kryen detyrat e caktuara:

11. Nxënësi dhe mentori duhet të angazhohen për bashkëpunim dhe përgatitje më të lartë për garat që paraprijnë

12. Mentori në kohë ti dorëzon materialet prej të cilave do të akumulohen të dhëna nga disiplina të caktuara.

Gjatë mbajtjes së garave duhet të respektohen rregullat në vijim:

1. Të bëhet lista e nxënësve që do të marrin pjesë në garën.

2. Të zgjidhet komision nga arsimtarë kompetent lëndorë

3. Komisioni të përpilon test për zbatimin e garës shkollore.

4. Testi duhet të jetë i standardizuar me detyra për dituri të nivelit të lartëtë caktohet koha, vendi dhe mënyra e realizimit të garës shkollore.

5. Dy ditë para garës së paraparë të lexohet lajmërimi në të gjitha paralelet.

6. Zhvillim i garave në atmosferë të qetë në kornizë kohore të caktuar.

Nëse mentori e përgatit nxënësin për gara të nivelit më të lartë, atëherë duhet të kemi kujdes që:

1. Arsimtari-mentor rregullisht nëpërmjet mësimit shtues ta përgatis nxënësin.

2. Arsimtari-mentor duhet të jetë rregullisht në dispozicion për mbështetje në mësimin e nxënësve që përgatiten.

3. Të krijohet ekip nga arsimtarë përkatës të cilët kanë për obligim të kontrollojnë rregullshmërinë në kryerjen e obligimeve gjatë përgatitjeve për garat e radhës.

4. Hapet dosje për çdo lëndë mësimore në të cilën regjistrohen aktivitetet, prania, fletore dhe material ku realizohen ushtrimet përgatitore.

5. Dosja është e kapshme për shërbimin profesional dhe Drejtorin në qoftë se duan ta shfletojnë.

6. Në përgatitjet duhet të përfshihet edhe material jashtë programit mësimor.

7. Lajmërim në kohë të duhur rreth pjesëmarrjes të nxënësve dhe arsimtarëve të tjerë.

Këshilli i arsimtarëve dhe parlamenti i nxënësve mundën të propozojnë ndryshim të këtyre rregullave për ndryshimet vendoset duke u arritur koncenzus sipas regullativave ligjore dhe dokumenteve të tilla në fuqi.

Sipas mundësive në përputhshmëri me Rregulloren për shpërblimin e nxënësve shkolla do të mundëson shpërblime simbolike dhe diploma/falënderime për nxënësit më të mirë.

Plani për gara

- Garë shkollore në matematikë-Mars.
- Garë shkollore në Gjeografi, Histori.
- Arsim fizik dhe shëndetësor-aktivitete sportive për patronatin e shkollës.
- Konkurs nga arti figurativ për patronatin e shkollës.
- Ndihma e parë Maj/Qershor.
- Gara nga fizika-Prill/Maj.
- Gjuhë angleze-Prill.

Arsimtarët e mësimi të lëndëve mësimore sipas zgjedhjes së lirë do organizojnë dhe gara të tjera ndërmjet klasave sipas mundësive dhe arritjes së rezultateve.

13. Avancimi i multikulturalizmit/interkulturalizmit dhe integritit ndëretnik

Ekipi për integrimin shkollor :Verim Zendeli ,Fetanete Adili ,Rizvan Asani,Venhar Velija Ganimete Ilazi .Shkolla jonë ka memorandum bashkëpunimi me shkollën Strasho Pinxhur”-Kavadar ku cdo vitë realizohen aktivitete ndëretnike të cilat financohen nga Ministrija e kulturës dhe vetqeverisja lokale

Programi për Integrim ndëretnik në arsim:

Një komponent i rëndësishëm në procesin edukativo - arsimor dhe në zhvillimin e përgjithshëm të individit është bashkëjetesa e të gjitha grupeve etnike në komunitet. Përveç shumë titujve për këtë temë në tekstet shkollore për nxënësit, do të realizohen edhe aktivitete të ndryshme në shkollë. Me qëllim për të ruajtur multikulturalizmin, planifikohet të organizohen shumë evinemente në shkollë dhe jashtë saj, në bashkëpunim me komunitetin lokal dhe shkollat e tjera të cilët gjithashtu e kanë këtë komponent. Në shkollën tonë do të realizohen lloje të ndryshme të ngjarjeve tematike, ekskursione, shfaqje, maskenballa dhe

ahengje. Qëllim i të njëjtëve është që përmes argëtimit dhe krijimtarisë të njohin zakonet dhe kulturat e shokëve të tyre nga grupet e ndryshme etnike. Në shtojcë jepet plani aksionar në kuadër të këtij komponenti të multikulturalizmit.

Qëllimet	Aktivitetet	Realizues	Koha e realizimit	Resurset	Efektet e pritura
Vazhdim i realizimit të aktiviteteve nga projekti IOM	Planifikimi IOM aktiviteteve në programin vjetor	Ekipi për integrim shkollor	Gusht 2024	Programi vjetor për punën e shkollës	Përgatitje e planeve aksionare për aktivitete ndëretnike për INA në Programin vjetore për punën e shkollës
Përputhshmëria e IOM për planifikimin e aktiviteteve në nivel shkollor	Takim i përbashkët, aktivitete dhe përpunimi i raportit	Ekipi shkollorë për realizimin e projektit	Gusht 2024	Planet aksionare dhe raportet	Marrëveshje e përbashkët, bashkëpunim, plan i përputhshëm për detyrat e caktuara
Mbledhje me ekipin e shkollës partnere për planifikim e aktiviteteve të përbashkëta	Konkretizimi i aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet dy shkollave	Ekipet për integrim shkollor nga të dy shkollat	Gusht 2024	Plani aksionar për aktivitetet e përbashkëta	Trajnimi i kapaciteteve shkollorë për realizimin e integrimin ndëretnik në arsim
Përforcimi i kapaciteteve shkollorë për realizimin e integrimin ndëretnik në arsim	Realizimi i aktiviteteve vetanake punëtori nga arsimi për shkathtësi jetësore, aktivitete për pjesëmarrje demokratike të nxënësve	-Ekip për integrim shkollor - Arsimtare -Nxënës -Bashkësia e nxënësve - Ekipi për përkrahje të bashkësisë së shkollës	Shtator 2024 – Qershor 2025	- Doracak për - Programi për punën e ekipes shkollorë - Programi për punën e bashkësisë së shkollës	Zbatimi i suksesshëm i aktiviteteve të planifikuara në shkollë
Koordinimi i aktiviteteve ndërmjet shkollave partnere, pjesëmarrje në mbledhje për shkëmbim të përvojave me shkolla tjera		-Ekip për integrim shkollor - Arsimtare -prinde -Nxënës	Janar – Qershor 2025	-- Planet aksionare - Programi për punë -Përgatitje ditore , tematike	Gadishmeria për bashkëpunim dhe interakcion Realizimi i suksesshem i aktiviteveper integrim nderetnik me

				- rregulloret	shkollat partnere
--	--	--	--	---------------	-------------------

Inicim I aktiviteteve për inkuadrimin e prindërve dhe Komunës për integrim ndëretnik në arsim dhe koordinimin e realizimit të saj	Bashkëpunim me prindërit dhe Komunën	-Ekip për integrim shkollor - Arsimtare -Prind -Nxënës - Këshilli i prindërve - këshilli i shkollës	Shtat or 2024 Qesh or 2025	- Planet aksionare - Programi për pune - rregulloret	Inkuadrim aktiv dhe përkrahje në implementimin dhe promovimin e aktiviteteve vetanake (të panvarura)
---	--------------------------------------	--	----------------------------	--	---

15. Mbështetja e nxënësve

15.1. Arritjet e nxënësve

Shkolla në vazhdimësi ndjek planifikimin dhe realizimin dhe notimin dhe vlerësimin e të të arriturave të nxënësve, e që ky i fundit, pra vlerësimi të jetë më isaktë dhe të korespondojë me realitetin, mësimdhënësit ndjekin vazhdimisht të arriturat e nxënësve dhe vlerësojë ato në mënyra të ndryshme si vlerësimin formativ, mikrosumativ dhe sumativ. - Nga evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik, raportet, statistikën, fletat e evidentues për suksesin e nxënësve në periudhën kualifikuese gjatë viteve shkollore, bisedave me mësimdhënësin, pedagogun, drejtorin si duket janë mirë të përpunuara të cilat shërbejnë gjatë evaulimeve të ndryshme, shkolla luan rol të rëndësishëm në përmisimin e të arriturave të nxënësve. Shkolla merr dhe përpunon të dhëna nga kujdestarët e klasave për vlerësimet në tremujorin e parë, gjysmëvjetorin, tremujorin e tretë dhe në fund të vitit shkollor.

Përveç se për suksesin, përpunohen të dhëna edhe për sjelljen dhe rregullshmërinë e nxënësve për secilin tremujor shkollor. Si dukuri në vitet e fundit edhe këto dy vite shkollore, karakteristikë është se numri i nxënësve është në ulje nga viti në vit.

- Shkolla ka shënime të mjaftueshme për arritjet e nxënësve, në bazë të gjinive, lëndëve mësimore, sipas periudhave kualifikuese dy vitet e fundit. Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Fillor, në shkollën tonë realizohen këto lloje notimesh:

Notimi përshkrues realizohet në klasat: I, II, III; notimi i kombinuar (përshkrues dhe numerike) IV; V; VI si dhe përshkrimi numerik VII; VIII; IX. Sa i përket suksesit të nxënësve në periudhat kualifikuese të dy viteve të fundit, shkolla ka të dhëna të mjaftueshme për suksesin e nxënësve më të detajuara në çdo periudhë kohore, edhe atë:

Dy vitet e fundit në bazë të dinamikave të periudhave kualifikuese në vitet shkollore kemi këtë sukses të nxënësve e cila është e paraqitur në mënyrë tabelare mëposhtë:

Pasqyra e suksesit të përgjithshme të nxënësve sipas gjuhës mësimore në fund të vitit shkollor 2022/2023 mësimi në gjuhë shqipe.

KLASA	Gjithësejt-Вкупно		1		2		3		4		Вкупно Gjithëse		1		2		3		4		Сред наоцен/Nota mesatare	
	Nxënës Ученици		Одличен Shkqy		Мн.Доб Sh.mirë		Добри mirë		Довол Mjaft.				Me 1 të dobët		Me 2 të dobë ta		Со 3 е мë shumë të dobëta		Неоцените/ Тë panotuarit			
	Ce/gj	ж/ф	Бр/п r	%	Бр/п r	%	Бр/ п r	%	Бр/п r	%	Бр	%	Бр.	%	Бр.	%	Бр.	%	Бр.	%		
I	45	25									43								2			
II	58	24									54								4			
III	46	17									45								1			
IV	79	44	23	42	12	20	4	8	2	5	75								4		4.22	
V	61	30	25	34	2	12	0	7	2	4	57								4		4.07	
I-V	289	140	48	76	14	32	4	15	4	9	274								15		4.14	
VI	86	43	19	35	13	21	5	16	3	5	77								9		3.73	
VII	77	40	20	33	6	14	4	14	4	10	71								6		3,7	
VIII	61	27	14	24	5	8	5	19	3	9	60								1		3,67	
IX	72	34	21	23	2	10	7	18	2	10	69								3		3,6	
VI-IX	296	144	74	115	26	53	21	67	12	34	277								19		3,67	
I-IX	585	284									551								34		3,90	

**Pasqyra e suksesit të përgjithshme të nxënësve sipas gjuhës mësimore në fund të vitit shkollor
2023/2024 në gjuhën shqipe**

KLASA	Gjithësejt-Вкупно		1		2		3		4		Вкупно		1		2		3		4		Сред	
	Nxënës Ученици		Одличен Shkqy		Мн.Доб Sh.mirë		Добри mirë		Довол Mjaft.		Gjithëse		Me 1 të dobët		Me 2 të dobët a		Со 3 сл. Me 3 e më shumë të dobëta		Неоцените/ Të panotuarit		наоцен/Nota mesatara	
	Ce/gj	ж/ф	Бр/нр	%	Бр/нр	%	Бр/ нр	%	Бр/нр	%.	Бр	%	Бр.	%	Бр.	%	Бр.	%	Бр.	%		
I	57	26									49								8			
II	44	26									41								3			
III	56	23									53								3			
IV	47	20	26	12	7	3	6	3	3	0	42								5			3.96
V	74	39	43	25	16	12	7	3	4	2	71								3			4.22
I-V	278	134	69	37	23	15	13	6	7	1	256								22			4.9
VI	62	31	25	20	8	5	11	0	9	2	53								9			3.11
VII	85	43	27	15	19	11	23	9	8	4	77								8			3,49
VIII	70	33	30	20	13	5	13	4	12	4	68								2			3.74
IX	60	27	24	15	11	6	12	2	10	3	57								3			3.86
VI-IX	277	134	106	70	51	27	59	15	39	11	255								24			3.66
I-IX	555	268	175	107	74	42	72	21	46	12	511								44			4.28

Përmirësimi i të arriturave të nxënësve është arritur me anë të angazhimit(mundësive) me kuadër përkatës profesional, përmirësim dukshëm të kushteve,aplikimin e mjeteve mësimore dhe ndihmëse, literaturë profesionale , zbatimin eTIK-ut në mësim, mënyrat dhe format e ndryshme të mësimit bashkohor, realizim të ekskurzioneve shkollore dhe aktiviteteve tjera jashtamësimore..

Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe – të gjithë nxënësit janë shqiptar, në bazë të statistikave dhe analizës krahasuese të gjinive, karakteristikënxënësit të gjinis femërore tregojnë rezultate më të mira të suksesit se sa meshkujt.

Shkolla ka mundësi të identifikoj nxënësit me nevoja të vecanta që kanë vështirësinë mësim, talent të veçant, diskutime, mbahen shënime nga kujdestarët e klasave dhe timi inkluziv i shkollës, mirëpo përparimi i tyre përcillet në mënyrë josistematike,dhe nuk ka plane dhe programe të veçanta diferenciale - duhet të përgatitenprocedura për këta nxënësi. Numri më i madh i arsimtarëve në mësim të rregullt sigurojnë përkrahje për nxënësit në mësim të rregullt që kanë vështërsi gjatë të mësuarit dhe mbajnë mësim plotësues (më e theksuar është në mësim klasor).

Për nxënësit e talentuar mbajnë mësim shtesë ku u jepet mundësia për shfrytëzim të materialit mësimor plotësues dhe marerial me burime të ndryshme informacionesh të cilat i prezantojnë përmes garave shkollore, komunale, regjionale në lëndë të ndryshme. Për nxënësit me nevoja të veçanta (arsimore) nuk ka paralele të veçantë po funksionon ekipi i inkluzionit, sipas rregullores dhe obligimeve ligjore.

15.2. Orientimi profesional i nxënësve

Si ndihmë gjatë vendosjes së nxënësve në zgjedhjen e shkollës së mesme në të cilën do të regjistrohen, pedagogu i shkollës harton dhe realizon Program për orientimin profesional për nxënësit e klasës së nëntë. Nëse ekzistojnë mundësi do të organizohet një vizitë nga nxënësit në shkollat e mesme, apo të sigurohen ligjërues që do t'i njoftojnë nxënësit me profesione të ndryshme. Do të organizohet edhe vizita e Panairit të Arsimit ku u prezantuan shkollat e mesme të Republikës së Maqedonisë

Programi për orientimin profesional të nxënësve

Aktivitetet	Resurset	Bashkëpunëtorët	Koha e realizimit
Anketë me nxënësit	listat anketuese	Nxënësit-shërbimi profesional	Mars
Vizita nga shkollat e mesme dhe prezantimi para nxënësve	materiali propagandues për shkollat e mesme, materiali për prezantim	përfaqësuesit e shkollave të mesme, profesorët, nxënësit shërbimi profesional	Mars - Prill
Shqyrtimi i konkursit për regjistrim në shkollën e mesme	konkursi	nxënësit, prindërit, kujdestarët e klasave shërbimi profesional	Prill
Orientimi profesional	testet, analiza, raporti	nxënësit, kujdestarët e klasave shërbimi profesional	Prill – Maj
Zbatimi i testeve për aftësitë dhe orientimin profesional nga Agjencia e Punësimit	testet, analiza, raporti	nxënësit, kujdestarët e klasave shërbimi profesional	Prill – Maj
Prezantimi i rezultateve të marra – intervistë me nxënësit	testet, analiza	nxënësit, prindërit, kujdestarët e klasave shërbimi profesional	Prill – Maj
Bisedë me nxënësit	konkursi për regjistrim në shkollë të mesme, materiali propagandues	Nxënësit shërbimi profesional	Maj

Persona përgjegjës: Ekipi për orientim profesional në shkollor, shërbimi pedagogjiko-psikologjike drejtori dhe kujdestaret e klasave të IX

15.3. Promovimi i mirëqenies së nxënësve, mbrojtja nga dhuna, nga keqpërdorimi dhe neglizhimi, parandalimi i diskriminimit.

Përmbajtja, qëllimet dhe aktivitetet në këtë fushë janë përfshirë në programet shtesë për: Kujdesin shëndetësor, parandalimin e sjelljes së dhunshme, punën e Parlamentit të nxënësve. Disa nga përmbajtjet dhe aktivitetet do të realizohen gjatë orës së kujdestarisë.

Protokolli për reagim në rast të dhunës në shkollë

Akti i dhunës

ARSIMTAR	NXËNËS
- Arsimtari, kujdestari i klasës, arsimtari i lëndës ose ndonjë tjetër më i rritur duhet të reagojë menjëherë për t'i dhënë fund dhunës - Ndan nxënësit nëse bëhet fjalë përleshje fizike - Nëse arsimtari vlerëson se ai nuk do të jetë në gjendje ta parandaloj situatën vetë, duhet të kërkon ndihmë nga siguriimi shkollor, policia ose të rrituri tjetri ose bashkëpunëtori profesional, Telefonon ose siguron ndihmën e parë në rast të lëndimit - Nëse bëhet fjalë për maltretime, kërkohet ndërprerje e ndërmjet palëve të përfshira	Një nxënës i cili është viktimë ose dëshmitar i dhunës është i detyruar të kërkojë ndihmën e kujdestarit të klasës, arsimtarit ose shërbimit profesional

Sjellja pas aktit të dhunës

Arsimtar	Nxënës	Prind	SHËRBIMI PROFESIONAL	shkolla
Një arsimtar i cili ka informacione për	Një nxënës përfshirë në një	Prindi i nxënësit të përfshirë në	- Shërbimi profesional pas raportimit të incidentit të dhunës është i detyruar të hetojë rastin, duke marrë një deklaratë nga të gjitha palët e përfshira dhe	Shkolla shqipton një masë pedagogjike për

një incident të dhunës është detyruar a informojë drejtorin dhe shërbi min profesional	incident të dhunës është i detyruar ta raportojë atë tek kujdestari i klasës ose shërbi mi profesional	incidentin e dhunës është i detyruar t'i japë një deklaratë kujdestarit të klasës shërbi mit profesional ose drejtorit	subjektet e tjera relevante (bashkësia e klasës, arsimtari i lëndës, prindër, policia, qendrat për punë sociale etj.) - Shërbimi profesional ndërmerr bisedë këshillimore me nxënësit, prindërit dhe nëse është e nevojshme bashkëpunon me institucione të tjera - Shërbimi profesional është i detyruar të informojë drejtorin, këshillin arsimor dhe institucionet e tjera përkatëse për aktivitetet e kryera për të zgjidhur incidentin e dhunës.	nxënësit e përfshirë në një incident të dhunës në varësi të ashpërsisë së veprës së kryer dhe sipas Rregullores për shqiptimin e masave pedagogjike të MASH
--	--	--	--	---

Persona përgjegjëse: shërbimi pedagogjik, drejtori dhe kujdestaret e klasave

Klima socio – emocionale pozitive

Në mësim nuk është me rëndësi vetëm arritja e notave të mira, por edhe nxënia e përvojës që do të ndihmojë për funksionimin e mëtijshëm me sukses të nxënësit në shoqërinë demokratike. Për këtë, realizimi i qëllimeve edukativo-arsimore në shkollë në masë të madhe varet nga klima socio - emocionale që ekziston në shkollë.

Në krijimin e klimës pozitive në shkollë tonë ndikojnë më tepër faktorë, të cilat në mënyrë të ndërsjellë janë të lidhura dhe të ngatërruara. Një pjesë prej tyre janë relativisht objektive dhe më vështirë mund të ndryshohen, si për shembull: madhësia e vendit ku gjendet shkolla, numri i nxënësve në klasë, struktura socio- demokratike e nxënësve, etj. Tjerat janë subjektive dhe në këto mund të ndikohet, e me këtë mund të ndryshohet edhe klima në shkollë dhe klasë. Në mesin e të gjitha këtyre faktorëve, rol kryesor ka mësimdhënësi, me stilin e tij të udhëheqjes, karakteristikat e tij personale dhe me profesionalizmin e tij. Klima pozitive kontribuon

edhe për angazhim më të madh dhe më cilësor të mësimeve gjatë realizimit të qëllimeve të vendosura edukativo-arsimore, arritjes më të mirë në shkollë, qëndrimeve pozitive të nxënësve ndaj mësimeve dhe ndaj shkollës, si dhe ndaj marrëdhënieve të mira ndërpersonale.

Në përgjithësi, duke punuar në krijimin e klimës socio - emocionale në shkollën tonë, jemi të orientuar në qëllimin që njëkohësisht të mbahet kujdesi për nevojat emocionale dhe sociale të nxënësve. Zhvillimi i sjelljes së mirë në klasë nga aftësia e mësimit t'i plotësojë nevojat sociale dhe emocionale të nxënësve. Një vëmendje e posaçme i kushtohet grupit të prekur e të detektuar të nxënësve në këtë aspekt, me ç'rast mësimit tanë udhëhiqen sipas parimeve në vijim:

- Mësimit është i gatshëm t'i dëgjojë nxënësit;
- Mësimit është i gatshëm t'u përgjigjet sugjerimeve të tyre;
- Mësimit është i gatshëm t'i pranojë dhe kuptojë ndjenjat e tyre;
- Mësimit është i gatshëm t'i përfshijë në procesin mësimor dhe t'i inkurajojë gjatë punës.

Këto komponentë që janë pjesë e marrëdhënieve ndërpersonale të cilat ekzistojnë në klasë mundësojnë të ekzistojë liria në komunikim, të marrin pjesë gjatë miratimit të vendimeve, të stimulojnë udhëheqjen e nxënësit, fleksibilitetin, etj. Në këtë mënyrë, arrijmë të krijojmë një klimë emocionale të mirë, të mbështetur dhe pozitive në klasë.

Shërbimi profesional në shkollë është detyruar për planifikimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve në këtë fushë, e këto parashihen në Programin vjetor për punën e pedagogut të shkollës.

16. Notimi

16.1. Llojet e notimit dhe kalendari i notimit

Në pajtim me ligjin për arsim fillor në klasat e ulta I - III të arriturat e nxënësve notohen me shkrim. Për këtë qëllim arsimtarët shfrytëzojnë lista evidentuese, pyetësorë, teste, raporte dhe mbahet edhe dosje e nxënësve. Dosja apo portofolio është e mbledhur nga mendi i nxënësve, hartime me shkrim, detyra kontrolluese dhe shënime për gjendjen shëndetësore dhe gjendjen sociale. Notimi formativ i nxënësve realizohet në mënyra të ndryshme, nëpërmjet instrumentit me shkrim, teste kontrolluese, kontrollim gojor, çek listave etj.

Mënyra e notimit bëhet në bazë të ligjit për arsim fillor klasat I – III notohen me notim përshkrues, klasat IV-VI me notim të kombinuar me shkrim dhe numerik kl.VII-IX numerik duke u mbështetur në përcjelljen e të arriturave të nxënësve me metoda portfolio, teste, instrumente, me gojë, me shkrim, çek lista, lista evidentuese, fleta analitike. Një numër i arsimtarëve mbajnë evidencë për çdo nxënës gjatë vitit shkollor –për përcjelljen e të arriturave si dhe formën e përfshirjes së nxënësve në vetvlerësimin në bazë të metodave dhe formave për notim. Në shkollë pjesa më e madhe zbatojnë (standardet dhe kriteret e notimit të dhëna nga B.ZH.A dhe M.A.SH), me çka zbatohen aktet ligjore të cilat rregullojnë procedurën e notimit.

Notimi është real, transparent dhe përcillet me diskutime të cilat u ndihmojnë nxënësve në punën e tyre si dhe biseda, konstatime që vlerësimi i nxënësve është bazuar në suksesin mesatar të shkollës është më i lartë bazuar në gjendjen faktike gjatë mësimit. Në kontinuitet nxënësit marrin informata për përparimin e tyre nëpërmjet rezultateve të instrumenteve me shkrim(Fletat evidentuese-teste) dhe kontroll me gojë me qëllim të nxitet dëshira për përparim.

Detyrat		PËRCJELLJA DHE VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE																	
Aktivitetet		Korniza kohore (muaj)																Përcjellje)	
		9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	Bartës	Mënyra e zbatimit(resurse)	instrumente	Rezultatet e pritura		
Vlerësimi intern	Vlerësim sumativ numerik i të arriturave të nxënësve nga tremujorin e dytë (IV - VI)													arsimtarë	Përgjigje me shkrim, bisedë, kontrolli, e, me shkrim, projekte, aktivitete, vetë vlerësim ndërmjet nxënësve, notim, portfolio e nxënësit	Lista mësimore, teste kontrolluese projekte, kuis pyetje, detyra shtëpie, cek lista, lista analitike, lista holistike	Përmirësim i mësimit dhe të mësuarit		
	Vlerësim sumativ numerik me shkrim i të arriturave të nxënësve nga tremujorin e tretë (VII, VIII dhe IX)													arsimtarë	Mbledhja e të arriturave të nxënësve gjatë një periudhës, sipas standardeve dhe kriteriumeve për vlerësim	Listat evidentuese për aktivitete dhe të arriturat, standardet dhe kriteret për vlerësim			
	Vlerësim sumativ me shkrim i të arriturave të nxënësve nëpërmjet kontrollit me shkrim(hartime me shkrim)													arsimtarë	Mbledhja e të arriturave të nxënësve gjatë një periudhës, sipas standardeve dhe kriterëve për vlerësim	Listat evidentuese për aktivitete dhe të arriturat, standardet dhe kriteret për arriturat, vlerësim			

Detyrat		PËRCJELLJA DHE VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE																
Aktivit etet		Korniza kohore (muaj)																Përcjellje
		9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	7	8	Bartës	Mënyra e zbatimit(resurse)	instrumente	Rezultatet epritura	Personi përgjegjës
Vlerësimi intern	Vlerësim formativ i të arriturave të nxënësve(gojarisht ose me shkrim)													arsimtarë	Përgjigje me shkrim, bisedë, kontrolli, e, me shkrim, projekte, aktivitete, vetë vlerësim ndërmjet nxënësve, notim, portfolio e nxënësit	Lista mësimore, teste kontrolluese, projekte, kuiz, pyetje, detyra shtëpie, cek lista, lista analitike, lista holistike	Përmirësim i mësimit dhe të mësuarit	
	Vlerësim sumativ me shkrim i të arriturave të nxënësve nga tremujorin e parë (I-III)													arsimtarë	Mbledhja e të arriturave të nxënësve gjatë një periudhe, sipas standardeve dhe kriteriumeve për vlerësim	Listat evidentuese për aktivitete dhe të arriturat, standardet dhe kriteret për vlerësim		
	Vlerësim sumativ me shkrim i të arriturave të nxënësve në tremujorin e dytë (IV - VI)													arsimtarë	Mbledhja e të arriturave të nxënësve gjatë një periudhe, sipas standardeve dhe kriterëve për vlerësim	Listat evidentuese për aktivitete dhe të arriturat, standardet dhe kriteret për arriturat, vlerësim		

16.2. Ekipi për ndjekje, analizë dhe mbështetje

Në shkollë në kontinuitet kryhet përcjellja dhe kontrollimi i përputhshmërisë të vlerësimit sipas standardeve të parapara.

Në pajtim me Ligjin për arsim fillor, është miratuar procedura për ankesa për notat e që i kanë marrë, si dhe mënyra e informimit të prindërve dhe nxënësve. Përcjellje, analizë dhe përkrahje gjatë përputhshmërisë të vlerësimit me standardet e parapara që i kryen drejtori, shërbimi profesional dhe ekipi e shkollës për vlerësim ku bëjnë pjesë:

Lindihana Ebibi-për vlerësim formativ dhe sumativ

Ferdane Velija - për vlerësim formativ dhe sumativ

Ambera Shabani- për vlerësim formativ dhe sumativ

Të gjitha aktivitetet zhvillohen më bashkëpunim me arsimtarët e grupit lëndorë klasor dhe kujdestarët e klasës

Shërbimi profesional përgatit analiza të rezultateve të arritura të nxënësve e cila është bazë themelore për analizën e punës së arsimtarëve.

16.3. Vizita profesionale për ndjekjen dhe vlerësimin e cilësisë së punës së kuadrit edukativo-arsimor

Këtë vit vëmendja do të jetë te ndjekja dhe vlerësimi i planifikimit dhe përgatitjes në mësim. Të gjithë arsimtarët e lëndës janë të obliguar deri më 1 shtator të dorëzojnë plane vjetore globale si dhe temat e para mësimore. Gjithashtu çdonjëri prej tyre duhet të posedon përgaditje ditore për realizimin e orës mësimore e cila do jetë temë e analizës sistematike dhe vlerësimit. Do ndiqet dhe evidentohet çdo vërejtje në vështirësi të vështirësive dhe dobësive veçanërisht në planet dhe programet e reja mësimore me qëllim që të njëjtat të tejkalohen.

Ndjekja dhe vlerësimi i punës së arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional do ta kryejnë drejtori, pedagogu këshilltarët nga Zyra për zhvillimin e arsimit dhe Inspektorati shtetëror i arsimit katër herë në vit (dy herë në çdo gjysëmvetor) mbi çdo mësues/ arsimtar për cilësinë e planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies herë në vitë. Ndjekja dhe vlerësimi i punës së arsimtarëve do përfshijë në vijim: Mësimin dhe lloje të tjera të punës të organizuara me nxënësit;

- Ndjekja dhe notimi i nxënësve;
- Planifikimi i mësimit dhe zgjedhja e formave, metodave dhe mjeteve për realizimin e tij;
- Përgatitja e mjeteve didaktike;
- Bashkëpunimi me prindërit; Programi vjetor për punë i shkollës fillore në vitin shkollor 2022/23
- Kryerja e detyrave të kujdestarit të klasës;
- Pjesëmarrje në kontrollim intern të nxënësve;
- Udhëheqja e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit.
- Rregullimi i kabineteve, përmbledhjeve, punëtorisë së shkollës, ushtrimeve, fushave sportive, mbjelljeve dhe të tj.
- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive;
- Udhëheqja e aktiviteteve të lira të nxënësve dhe puna me proekte dhe hulumtime me nxënësit;
- Përgaditje dhe udhëheqje të ekskurzioneve, piknikeve, garave, mësim në natyrë etj

Kryerja e punëve tjera të parapara me programin vjetor; Shërbimi profesional dhe drejtori në vazhdimësi udhëheqin kartonin pedagogjik për arsimtarin dhe Dosien profesionale për arsimtarët dhe bashkëpunëtorëve profesional. Çdo arsimtar udhëheq portfolion e vet personale.

16.4. Vetevaluimi i shkollës

Formimi i ekipit për vetevaluim (N.R. 02 – 96/ të 16.02.2024 këshilli i shkollës)

Sipas Ligjit për arsimin fillor, shkolla kryen vetevaluim të të gjithë punës çdo dy vjet. Vetevaluimi bëhet sipas Rregullores së vetevaluimit në shkollat fillore dhe treguesve për matjen e cilësisë së punës në shkollë të përgatitur nga inspektorati shtetëror i arsimit.

Zbatues të vetevaluimit do të jenë shtatë ekipe të arsimtarëve klasor dhe lëndor, bashkëpunëtorë profesional dhe prindër, të cilët do të punojnë në fushat e mëposhtme: plan-programet mësimore, arritjet e nxënësve, mësimi dhe mësimdhënia, mbështetja e nxënësve, klima në shkollë, resurset, udhëheqja dhe krijimi i politikave.

Këtë vit shkollor, vetevaluimi i shkollës duhet të bëhet për dy vitet e fundit.

Vetevaluimi bëhet nga një komision shkollor i përbërë nga pesë anëtarë nga radhët e mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, prindërve/ kujdestarëve, i cili formohet nga këshilli i shkollës me propozimin e drejtorit. Vetevaluimi kryhet në tre faza: faza përgatitore, faza e realizimit dhe faza e raportimit dhe adoptimit sipas planit të vendosur.

Për anëtarë të komisionit zgjidhen:

1. Drejtor
2. Riad Bajrami-Kryetar i këshillit të prindërve
3. Lindihana Ebibi-Edukatore Speciale
4. Fetanete Adili-Mësimdhënëse-Grup klasaor
5. Behije Jonuzi -Mësimdhënëse -Grup lëndor

Përveç antarëve të Komisionit, në mbledhje marr pjesë edhe Sekretari I shkollës në rolin e proçesverbalistit I cili edhe u angazhua të merr pjesë në çdo mbledhje të të gjitha komisioneve në rolin e Këshilluesit dhe proçesverbalistit.

- Dukë u bazuar në sferën **nr.1 Programet dhe planet mësimore**, propozohet që ekipin ta përbëjnë këto antarë:
 - Ilvana Halili– Mësimdhënëse
 - Zana Dalipi– Mësimdhënëse
 - Shasine Ragibi– Mësimdhënëse
 - Bleona Pajaziti –Nxënës
 - Besim Haliti -Prind
- Dukë u bazuar në sferën **nr.2 Të arriturat e nxënësve**, propozohet që ekipin ta përbejnë këto antarë:
 - Ferdane Velija – Pedagog
 - Florije Bilalli– Mësimdhënëse
 - Mirzana Jaja – Mësimdhënëse
 - Erina Halili–Nxënës
 - Ramis Imeri-Prind
 -
- Dukë u bazuar në sferën **nr.3 Mësim dhe proces mësimor**, propozohet që ekipin ta përbejnë këto antarë:
 - Rabi Ismaili-Nd.drejtor
 - Drita Saliji– Mësimdhënëse

- Selime Tahiri– Mësimdhënëse
 - Emine Musliu –Nxënës
 - Berat Haliti -Prind
-
- Dukë u bazuar në sferën **nr.4 Mbështetje/ndihmë për nxënësit**, propozohet që ekipin ta përbejn këto antarë:
 - Mjaftime Dalipi -Mësimdhënëse
 - Alemine Bilalli – Mësimdhënëse
 - Sahide Ebibi– Mësimdhënëse
 - Hana Xheladini–Nxënës
 - Arife Kamberi-Prind
-
- Dukë u bazuar në sferën **nr.5 Klima shkollore**, propozohet që ekipin ta përbejn këto antarë:
 - Mirzana Selmani-Mësimdhënëse
 - Hanife Bajrami– Mësimdhënëse
 - Ismije Maliki– Mësimdhënëse
 - Vigan Selmani–Nxënës
 - Gazmend Tahiri-Prind
-
- Dukë u bazuar në sferën **nr.6 Resurset (burimet)** nga, propozohet që ekipin ta përbejn këto antarë:
 - Verim Zendeli –Mësimdhënëse
 - Blerta Amiri– Mësimdhënëse
 - Ganimete Ilazi– Mësimdhënëse
 - Zerina Jonuzi–Nxënës
 - Gadaf Bexheti -Prind
-
- Dukë u bazuar në sferën **nr.7 Udhëheqje/menaxhim me shkollën dhe krijimi i politikave të shkollës**, propozohet që ekipin ta përbejn këto antarë:
 - Rizvan Asani–Mësimdhënëse
 - Arjeta Kamberi – Mësimdhënëse
 - Mjaftime Zulbehari– Mësimdhënëse
 - Jasin Amiri–Nxënës
 - Denis Alija -Prind

17. Siguria në shkollë

Në shkollën tonë zbatohen programe parandaluese përmes të cilave kemi për qëllim të ofrojmë siguri dhe klimë të mirë për punë për të gjitha subjektet në shkollë. Një vëmendje e posaçme i kushtojmë parandalimit të çdo lloji të dhunës në shkollë për çka ekipi i shkollës ka hartuar Protokoll për mbrojtjen e nxënësve nga dhuna, keqpërdorimi dhe veprimi i keq në shkollë. Përgjegjësia e të gjitha subjekteve është ta zbatojnë politikën kundër dhunës.

Në kornizat e Programit për mbrojtjen shëndetësore, si dhe në programin për shkathtësitë jetësore, nxënësit njihen me sëmundjet e varësisë dhe parandalimi i tyre. Një pjesë e këtyre programeve parandaluese realizohen edhe në mësimin e rregullt, në orët e lëndëve dhe përmbajtjeve përkatëse.

Mbrojtja nga zjarret, vërshimet dhe tërmetet është paraparë sipas planit në vijim:

Mbrojtja nga zjarret, tërmetet dhe fatkeqësitë tjera

Përmbajtja - aktiviteti	Qëllimet	Realizuesi	Resurset	Efektet e pritura	Koha
Testimi i sinjaleve për rrezik	Përcaktimi i sinjalit të vërtetë	Ekipi i planifikimit	Plani	Nxënësit e njohin shenjën	Shtator
Aktiviteti i ushtruar kundër zjarrit gjatë mësimin të lëndës	Aftësimi i ekipit për veprim të shpejtë	Ekipi për mbrojtje kundërzjarrit	Aparatet kundërzjarrit	Ekipi është i gatshëm për aksion	Nëntor
Edukimi për aktivitetin e zbatuar	Shqyrtimi i lëshimeve	Ekipi i mësimdhënësve	Plani dhe procesverbali	Lëshimet shqyrtohen dhe mënjahen	Nëntor
Aktiviteti i ushtruar kundër zjarrit gjatë mësimin në klasë	Aftësimi i ekipit për veprim të shpejtë	Ekipi për mbrojtje kundërzjarrit	Aparatet kundërzjarrit	Ekipi është i gatshëm për aksion	Mar s
Evakuimi për aktivitetin e zbatuar	Shqyrtimi i lëshimeve	Ekipi i mësimdhënësve	Plani dhe procesverbali	Lëshimet shqyrtohen dhe mënjahen	Mar s
Testimi i sinjaleve për rrezik	Kontrolli për suksesin e sinjalit	Ekipi i planifikimit	Plani	Nxënësit e njohin sinjalin	Prill
Aktiviteti i ushtruar për ndihmën e parë mjekësore	Aftësimi i ekipit për ndihmën e parë	Ekipi për ndihmën e parë	Materiali mjekësor	Intervenimi praktik dhe me sukses	Maj
Evalvimi i aktiviteteve të zbatuara	Shqyrtimi i anëve pozitive dhe negative	Ekipi i mësimdhënësve	Procesverbalet	U shqyrtuan masat për më tutje	Maj

18. Kujdesi për shëndetin

18.1. Higjiena në shkollë

Shkolla gjatë pushimit veror i morri masat e nevojshme higjienike – teknike që të jetë e gatshme për punë në vitin e ri shkollor, edhe atë:

- pastrimi i përgjithshëm dhe rregullimi i të gjitha godinave të shkollës;
- prerja e barit dhe krasitja e drunjëve në oborret e shkollës;
- pastrimi dhe rregullimi i hapësirave të podrumit;
- pastrimi dhe dezinfektimi i nyjave sanitare;
- pastrimi dhe dezinfektimi i enterierit në klasat;

Programi operativ për higjienën e shkollës dhe shëndetin e nxënësve					
Aktivitetet e planifikuara të programit	Koha e realizimit	Nxënës të përfshirë	Subjekti përgjegjës	Forma	Qëllimet dhe efektet e pritura
Sigurimi i nxënësve	Shtator	Klasa 1-9	Shkolla	Grupore	Kompensimi gjatë lëndimeve eventuale
Java e luftës kundër tuberkulozit	Shtator	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Masat për mbrojtje dhe parandalim
6 Tetori: Dita Botërore për Kujdesin për Personat e Moshuar	Tetor	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Rritja e kujdesit për personat e vjetër në familje dhe jashtë saj
Ligjërimi me temë –verdhëza, sëmundje ngjitëse dhe mbrojtja	Tetor	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Si të mbrohemi nga verdhëza, masat dhe mbrojtja
16 Tetori: Dita Botërore e Ushqimit: Ushqimi i konsiderueshëm dhe i llojllojshëm – i rëndësishëm për shëndetin e nxënësve	Tetor	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Sa është i rëndësishëm ushqimi i llojllojshëm dhe si ta përmirësojmë
Pirja e duhanit, alkooli dhe droga janë të dëmshme për shëndetin	Nëntor	Klasa 1-9	Mësimdhënës i Pedagog	Frontale	Mbrojtja dhe parandalimi, largimi i nxënësve prej këtyre veseve

Ligjërimi me temën: Gripi dhe parandalimi nga gripi	Dhjetor	Klasa 1-9	Personi profesional	Frontale	Masat për mbrojtje dhe parandalim nga gripi
1 Dhjetori – Dita Botërore në Luftën Kundër Sidës	Dhjetor	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Edukimi për sëmundjen, si të mbrohem nga kjo sëmundje
Vitaminat-materiet plotësuese dhe mbrojtëse për shëndetin e njeriut	Dhjetor	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Përmirësimi i shëndetit të nxënësve përmes futjes së vitaminave në ushqim
Siguria dhe ndihma e parë	Shkurt	Klasa 1-9	Mësimdhënës Personi profesional	Frontale	Siguria e madhe për nxënësit në situata të ndryshme dhe ndihma e personave të cilëve u nevojitet

Programi operativ për kujdesin e shkollës për shëndetin e nxënësve					
Aktivitetet e planifikuara të programit	Koha e realizimit	Nxënësit të përfshirë	Subjekti përgjegjës	Forma	Qëllimet dhe efektet e pritura
Ligjërimi për parandalimin e tërbimit të njerëzit	Shkurt	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Njohuri se si të mbrohem nga kjo sëmundje
Java e luftës kundër sëmundjeve të zemrës 21 - 28. 02	Shkurt	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Parandalimi dhe mbrojtja
Java e luftës kundër kancerit 01-08. 03	Mars	Klasa 1-9	Mësimdhënësi	Frontale	Njohuri se si të mbrohem nga kjo sëmundje
Mjedisi i pastër dhe i shëndoshë, aksioni i punës	Mars	Klasa 1-9	Shkolla	Grupore	Ngritja e vetëdijes ekologjike të nxënësit
Dita e Ekologjisë	Mars	Klasa 1-9	Shkolla	Grupore	Mirëmbajtja e higjienës në oborrin e shkollës, mirëmbajtja e mjedisit të shëndoshë dhe të pastër

Shënimi i 24 Marsit – Ditës së Luftës kundër Tuberkulozit	Mars	Klasa 1-9	Shkolla	Frontale	Si të mbrohemi nga kjo sëmundje
Pjesëmarrja në ndeshjet e basketbollit dhe futbollit	Sipas orarit	Klasa 1-9	Mësimdhë nësi	Grupore	Zhvillimi i drejtë i trupit, parandalimi i deformiteteve
Shënimi i 7 Prillit – Ditës Botërore të Shëndetit	Prill	Klasa 1-9	Mësimdhë nësi	Frontale	Ngritja e vetëdijes se si ta ruajmë dhe kultivojmë shëndetin personal
Pjesëmarrja në hepeningun ekologjik më 22. 04– Ditës së Planetit të Tokës	Prill	Klasa 1-9	Shkolla	Grupore	Si ta ruajmë dhe të kujdesemi për mjedisin e pastër jetësor
Ekskursioni njëditor me karakter shkencor mësimor	Maj	Klasa 1-9	Shkolla	Grupore	Aktivitetet fizike

18.2. Kontrolle sistematike dhe Vaksinimi

Kontrollet sistematike dhe vaksinimi do të realizohen gjatë vitit shkollor në përputhje me planin e ministrisë së shëndetësisë. Kontrollet sistematike dhe vaksinimit janë të përfshirë të gjitha klasat dhe realizohet në ambullantën e fshatit Negotinë

Plan për imunizimin e kontrollimeve sistematike					
Aktivitetet e planifikuara të programit	Koha e realizimit	Nxënësit e përfshirë	Mësimdhënësi përgjegjës	Realizues	Qëllimet dhe efektet e pritura
Kontrolli sistematik dhe rivaksinimi MRP	Sipas orarit të institucionit	Klasa 1	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, repart i imunizimit dhe kontrolleve sistematike	Masat për mbrojtje dhe parandalim, zbulimi me kohë i sëmundjeve dhe anomalive eventuale
Kontrolli sistematik dhe rivaksina DT dhe Polio	Sipas orarit të institucionit	Klasa 2	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, repart i imunizimit dhe kontrolleve sistematike	Masat për mbrojtje dhe parandalim, zbulimi me kohë i sëmundjeve dhe anomalive eventuale
Kontrolli sistematik	Sipas orarit të institucionit	Klasa 3	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, repart i imunizimit dhe kontrolleve sistematike	Masat për mbrojtje dhe parandalim, zbulimi me kohë i sëmundjeve dhe anomalive eventuale
Kontrolli sistematik	Sipas orarit të institucionit	Klasa 5	Udhëheqësi i klasës	Shtëpia e shëndetit, repart i imunizimit dhe kontrolleve sistematike	Masat për mbrojtje dhe parandalim, zbulimi me kohë i sëmundjeve dhe anomalive eventuale
Kontrolli sistematik dhe doza e parë e vaksinës HPV për vajzat	Sipas orarit të institucionit	Klasa 6-7	Udhëheqësi i klasës	Shtëpia e shëndetit, repart i imunizimit dhe kontrolleve sistematike	Masat për mbrojtje dhe parandalim, zbulimi me kohë i sëmundjeve dhe anomalive eventuale
Kontrolli sistematik dhe rivaksina Tetanus dhe Poliomialitis	Sipas orarit të institucionit	Klasa 8	Udhëheqësi i klasës	Shtëpia e shëndetit, repart i imunizimit dhe kontrolleve sistematike	Masat për mbrojtje dhe parandalim, zbulimi me kohë i sëmundjeve dhe anomalive eventuale
Vaksina Rubeola	Sipas orarit	Klasa 8	Udhëheqësi i klasës	Shtëpia e shëndetit, repart i imunizimit dhe kontrolleve sistematike	Mbrojtje dhe parandalim
Kontrolli i vaksinës BSZH	Sipas orarit të institucionit	Klasa 1-9	Udhëheqësi i klasës	Shtëpia e shëndetit, repart i imunizimit dhe kontrolleve sistematike	Suksesi në vaksinën e kryer paraprakisht

Planifikim i aktiviteteve për stomatologji preventive dhe edukim për shëndet oral

Aktivitetet e planifikuara të programit	Koha e realizimit	Nxënës it e përfshirë	Mësimdhënësi përgjegjës	Realizues	Qëllimet dhe efektet e pritura
Fëmijët e lindur në vitin 2012 mbushja e dhëmbëve tjerë të përhershëm, si dhe kontrolli	Shtator / Tetor	Klasa 6	Udhëheqësi i klasës	Shtëpia e shëndetit, reparti i stomatologjisë parandaluese	Masat për mbrojtje dhe parandalim
Fëmijët e lindur në vitin 2013 vazhdon mbushja e dhëmbëve të sapodalë të përhershëm, si dhe kontrolli	Tetor	Klasa 5	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, reparti i stomatologjisë parandaluese	Masat për mbrojtje dhe parandalim
Punëtorja e parë „Ndërtimi dhe funksioni i zbrazëtirës orale”	Tetor	Klasa 6 – 9	Kujdestari i klasës	Shkolla	Edukimi për shëndet oral
Punëtorja e dytë „Ushqimi i rregullt dhe kontrolli në futjen e sheqerit,”	Nëntor	Klasa 6 – 9	Kujdestari i klasës	Shkolla	Edukimi për shëndet oral
Fëmijët e lindur në vitin 2014 vazhdon mbushja e dhëmbëve të sapodalë të përhershëm, si dhe kontrolli	Nëntor / Dhjetor	Klasa 4	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, reparti i stomatologjisë parandaluese	Masat për mbrojtje dhe parandalim
Punëtorja e tretë „Punëtorja e drejtë orale,”	Shkurt	Klasa 6 – 9	Udhëheqësi i klasës	Shkolla	Edukimi për shëndet oral
Fëmijët e lindur në vitin 2015 vazhdon mbushja dhëmbëve të sapodalë të përhershëm, si dhe kontrolli	Shkurt / Mars	Klasa 3	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, reparti i stomatologjisë parandaluese	Masat për mbrojtje dhe parandalim
Punëtorja e katërt „Vizita e përhershme e stomatologut dhe përdorimi i fluorideve në qëllimet parandaluese,”	Mars	Klasa 6 – 9	Kujdestari i klasës	Shkolla	Edukimi për shëndet oral
Fëmijët e lindur në vitin 2016 vazhdon mbushja e dhëmbëve të sapodalë të përhershëm, si dhe kontrolli	Mars / Prill	Klasa 2	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, reparti i stomatologjisë parandaluese	Masat për mbrojtje dhe parandalim

Fëmijët e lindur në vitin 2017 mbushja dhe derdhja e molarit të parë të përhershëm	Prill / Maj	Klasa 1	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, reparti i stomatologjisë parandaluese	Masat për mbrojtje dhe parandalim
Kontrolli sistematik, mbushja e molarëve të parë të përhershëm, lëshimi i shënimeve mjekësore për regjistrim në klasën e parë	Maj	Regjistrimi	Kujdestari i klasës	Shtëpia e shëndetit, reparti i stomatologjisë parandaluese	Masat për mbrojtje dhe parandalim

Përgjegjës: Qendra medicinale, udhëheqësit e klasave dhe arsimtarët.

18.4. Edukimi për ushqim të shëndetshëm - kafjall në shkollat

Për ushqim të shëndetshëm do organizojnë në shkollën tonë projekt edukues që të njoftohen nxënësit, arsimtarët dhe prindërit e shkollës sonë për rëndësinë e ushqimit të shëndosh. Qëllimi i realizimit të projektit të përbashkët, është rritja e vetëdijes të popullatës dhe për ndërtimin dhe praktikimin e shprehive të shëndosha në ushqim, zhvillim dhe nxitje e krijueshmërisë, por edhe në të njëjtën kohë dhe të japim përkrahje për ditën e Shëndetësisë, si iniciativë globale për ndërtimin e gjeneratave të shëndosha.

Në kuadër të ditës së shëndetit, gjithashtu nxënësit e klasës së teta dhe të nënta nëpërmjet lojërave, vizatimeve dhe ligjëratave nxënësve të gjeneratave më të reja do u paraqesin rëndësinë e ushqimit të shëndosh.

19. Klima shkollore

19.1. Disiplina

Disiplina dhe rendi të nxënësit në shkollë është më se e nevojshme nëse duam të gjithë atë që e kemi planifikuar të realizojmë. Me fjalë të tjera, duke u mbështetur në kuptimin tradicional dhe shkollën tradicionale qëndrimet e të gjithë të punësuarve në shkollën tonë është se nxënësit janë të dëgjueshëm dhe të disiplinuar edhe pse kjo nuk korrespondon me realitetin, sepse që të kesh nxënës të urtë në klasë nuk dmth se ka edhe nxënës të disiplinuar. Përafërsisht të gjithë pajtohen se mënyra e mirë e mësimi nga ana e arsimtarit është themel për vendosjen e disiplinës në orë. Por, nxënësit megjithatë në momente do jenë të padëgjueshëm edhe te arsimtari më me përvojë dhe ky problem medoemos të zgjidhet.

Kur arsimtarët flasin për mosdisciplinën e nxënësve,duhet të kemi parasysh standardet se çka është jodisiplina dhe që kjo ndryshon prej arsimtari në arsimtar.Ndonjë arsimtar mund të kërkon qetësi të plotë gjatë kohës së orës mësimore kur nxënësit punojnë,gjersa ndonjë tjetër e lejon zhurmmën.Disa nxënës janë të qetë gjersa arsimtari hyn në klasë gjersa të tjerët mezi presin që të del arsimtari nga klasa dhe të bërtasin.

Preventivat për jodisciplinën nga arsimtar me përvojë në orën mësimore janë:

- Lëviz shpesh nëpër klasë dhe i pyet nxënësit si ia kalojnë,
- Kohë pas kohe me shiqim përshkoj tërë klasën,dhe nëse ndonjë nxënës është i padisciplinuar individualisht më afër ia tërheq vërejtjen,
- Nxënësi që flet pa u vërejtur i afrohet,
- Barabarësisht i kyçën të gjithë nxënësit në aktivitetin e orës.
- Kur punon frontalisht kohë pas kohe ndonjë nxënës do të shikon në sy,jo më gjatë dhe veçmas te nxënësit e padisciplionuar.
- Shpesh u ndihmon dhe i nxitë për punë nxënësit.,
- Shpesh i ndryshon aktivitetet dhe dinamikën e punës gjatë orës,
- Gjatë jodisciplinës së përhershme detyrimisht e regjistron dhe jep vërejtje,
- Shpesh ua ndron vendet nxënësve që të ik nga nxënësit e padisciplinuar.

Përgjegjës:Arsimtarët kujdestar,ndihmës drejtori,shëbimi profesional,arsimtarët.

19.2. Rregullimi estetik dhe funksional i hapësirës në shkollë

Komisioni për rregullimin e hapësirës shkollore funksionon në përbërjen e mëposhtme: mësues i arsimit figurativ, mësues i arsimit teknik, mësues përgjegjës të aktiveve profesionale dhe nxënësve kujdes i veçantë bëhet për të promovuar punën dhe arritjet e nxënësve duke përfshirë aktivisht edhe nxënësit në punën e komisionit, ku mund të miratojnë propozime, ide dhe realizime udhëheqësit e klasave dhe nxënësit nga klasa e tyre vazhdimisht kujdesen për hapësirën shkollore

Rregullimi i klasës dhe kateve, mirëmbajtja e higjienës në klasa, korridore dhe në oborrin e shkollës.

- Rregullimi i klasës dhe korridorit.
- Pjesëmarrje në aktivitet sipas Eko- programit
- Zbukurimi i klasës me rastin e vitit të ri.
- Pjesëmarrje në festën e vitit të ri dhe në panairë të tjera.
- Pastrimi i shkollës me rastin e ditës së ekologjisë
- Pjesëmarrje në çfaqje me rastin e festës së Patronatit

Persona përgjegjëse: Fetanete Adili, Floreta Bilalli dhe Mirlinda Muharemi

19.3. Kodet etike

- Konsistencë në zbatimin e Rregullores për sjelljen e punonjësve, nxënësve, prindërve dhe personave të jashtme
- Bashkëpunim për të përmirësuar procesin e ndërtimit të një atmosfere respekti dhe bashkëpunimi të të gjitha lëndëve në procesin arsimor, si bazë për zhvillimin e suksesshëm të punës arsimore, përmirësimin e disiplinës, punës dhe sigurisë në shkollë
- Të aplikojnë dhe promovojnë modelin e punës në grup, bashkëpunimit, gradualitetit dhe konstruktivitetit në qasjen për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve të ndryshme në jetën shkollore.
- Të përfundojnë analizat dhe rishikimin e rregullave ekzistuese, me përgatitjen e rregullave specifike, të përcaktuara qartë të sjelljes dhe mirësjelljes, duke marrë parasysh dokumentet e dërguara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (konceptet, rregullat, udhëzimet dhe standardet)

19.4. Marrëdhëniet mes të gjitha strukturave në shkollë

- Qëllimi strategjik i zhvillimit të shkollës është të përmirësojë sistemin e komunikimit midis të gjithë palëve të kyçura në procesin arsimor Të përmirësohet procesin i informimit në shkollë
- Të justifikohet bashkëpunimi midis mësuesve në aktivet profesionale
- Të justifikohet bashkëpunimi i kujdestarëve të klasave dhe klasave të tjera Të avancohet pjesëmarrja demokratike e nxënësve në jetën shkollore
- Të krijojë, zhvillojë dhe promovojë klimë shkollore midis respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, komunikimit konstruktiv dhe bashkëpunimit të të gjithëve (nxënësve , mësuesve, prindërve, Komunës si themelues) për të arritur qëllime të përbashkëta
- Qëllimet konkretet do të punohen vazhdimisht dhe sistematikisht, në përputhje me analizat dhe udhëzimet e procesit të vlerësimit të të arriturave

20. Zhvillimi profesional dhe në karrierë i kuadrit edukativo-arsimor

20.1. Detektimi i nevojave dhe prioriteteve

Ekipi për zhvillim profesional i kuadrit arsimor bën anketë për përgatitje profesionale dhe ekspertizë të kuadrit arsimor me qëllim të detektimit dhe definimit të nevojës për trajnime plotësuese.

Arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional përgatitin plan personal për zhvillim profesional me qëllim të vetëvlerësimit dhe përcaktimit të nevojave për përmasimin e kompetencave të tyre profesionale.

Në suaza të veprimit të aktiveve profesionale bëhen analiza, shkëmbehen përvoja, dituri dhe konkretisht definojnë dhe planifikohen përmbajtje për zhvillim profesional.

Nëpërmjet punës së organeve profesionale në shkollë përcillen informatat në kohë dhe planifikohet pjesëmarrja e kuadrit arsimor në trajnime dhe seminare të organizuara dhe aprovuara nga MASH, BZH dhe institucione të tjera.

Në shkollë me azhurnim të rregullt I të dhënave udhëhiqet dosja profesionale për çdo arsimtarë.

20.2. Aktivitetet për zhvillim profesional

Ekipi për zhvillim Professional, në bazë të analizave të bëra, nevoja të detektuara dhe përmbajtje të definuar për zhvillim profesional harton plan dhe programe për aktivitete (programe për aktivet profesionale, program për zhvillim profesional) të cilët përfshijnë trajnime interne dhe punëtori si dhe trajnime të organizuara nga institucione përkatëse.

20.3. Zhvillim personal profesional

Arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional, sipas rregulloreve nga MASH, hartojnë plan personal për zhvillim profesional

Planifikohen kompetenca të cilat duhet të merren ose përmirësohen, aktivitetet të cilat do të ndërmerren për përmirësimin e kompetencave: resurset e nevojshme : dinamika kohore dhe rezultatet e pritura. Në fund të vitit shkollor përgatitet raport për realizimin e planit. Aktivitetet për zhvillim profesional individual realizohen dhe vëzhgohen në bashkëpunim me ekipin për zhvillim profesional dhe drejtorin

20.4. Nxënie horizontale

Zhvillimi profesional në shkollë zhvillohet nëpërmjet mësimit horizontal apo mësim nga njeri-tjetri. Realizohet nëpërmjet mënyrave të ndryshme të organizuara të përcjelljes së diturive dhe shkëmbim të përvojave profesionale në shkollë në bashkëpunim me shkolla tjera.

Për mësimin horizontal rendësi të veçantë ka puna ekipore e cila mundëson reflektim dhe vlerësim të përvojës si dhe përcjellja e përvojave të mira. Format dhe metodat për realizimin e së njëjtës janë të inkorporuar nëpër programet për punë e organeve profesionale të shkollës, planet akcionare, si dhe program për zhvillim profesional.

20.5. Zhvillim në karrierë i kuadrit edukativo-arsimor

Vizioni për zhvillimin profesional të kuadrit arsimor:

Shkolla jonë do të përpiqet që puna në shkollë të bazohet në të drejtat e fëmijëve dhe multikulturalizmin, të përfshirjes (inkluzionin) në të cilën çdo fëmijë do të përparojë në bazë të aftësive të tyre individuale dhe të vetëdijesimit për të drejtat, obligimet dhe respektin të ndërsjellë, do të sigurojë mësimdhënie cilësore e ndihmuar me TIK dhe EKO standardet me të cilat nxënësit do të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe aftësi të nevojshme për funksionimin e përditshëm.

QËLLIMI: "Duam që shkolla jonë të krijojë bazë të ideve të mira për punë me nxënësit dhe bashkëpunimin me prindërit, t ë sigurojë resurse (burime) të veta për punë dhe të arrijë rezultate maksimale, të zhvillojë komunikim të mirë dhe bashkëpunim me mjedisin, me shkolla të tjera të qytetit, shtetit dhe më gjerë"

STRATEGJIA: "Mësimdhënësit, shërbimi profesional dhe drejtori të zhvillojnë dhe të nxisin një kulturë dhe praktikë të punës ekipore, përmes mësimit horizontal, respektit të ndërsjellë dhe tolerancës. Kjo do të përmirësojë cilësinë e njohurive, shkathtësive dhe aftësive të nxënësve dhe në fund të fundit do të rritet niveli i kënaqësisë nga puna e mësimdhënësve dhe do të zhvillohet motivimi për zhvillimin profesional të vazhduar të shkollës si organizatë e cila mëson "

Në bazë të kësaj rrjedhin disa qëllime afatgjata:

- Zhvillimi i kulturës së punës ekipore dhe të mësuarit horizontal
- Përmirësimi i cilësisë së procesit dhe rezultateve të mësimit dhe mësimdhënies;
- Përmirësimi i cilësisë së komunikimit ndërmjet gjithë subjekteve në shkollë;
- Zhvillimi i bashkëpunimit me bashkësinë lokale dhe shkollat e tjera;
- Promovimi i punës së shkollës;

Ekipi për zhvillimin profesional të kuadrit arsimor

- 1.Afërdita Hoda - drejtor
- 2.Rabi Ismaili- nd.drejtor
- 3.Lindihana Ebibi- shërbimi profesional
- 4.Fetanete Adili- prej aktivitet

21. Bashkëpunimi i shkollës fillore me prindërit/kujdestarët

21.1. Përfshirje e prindërve/kujdestarëve në jetën dhe punën e shkollës

Kyçja e familjes dhe e bashkësisë në punën e shkollës është një nga elementet kryesore për arritjen e rezultateve më të mira të nxënësve, si dhe shkolla më të hapura dhe demokratike. Duke u nisur nga interesat e përbashkëta të shkollës dhe prindërve, shkolla u mundëson prindërve që të organizohen. Këshilli i prindërve formohet për realizimin e organizuar të interesave të nxënësve në shkollën fillore . Prindërit në shkollë organizohen në Këshillin e prindërve në nivel të secilës paralele - dhe Këshill të prindërve në nivel të të gjithë shkollës. Prej Këshillit të prindërve të paraleleve zgjidhet nga një përfaqësues nga secila paralele dhe atë e zgjedhin prindërit në mbledhjen prindërore të paraleles, përfaqësues që anëtarësohen në KP në nivel të shkollës . Nga rradhët e KP zgjidhen përfaqësues për në Këshillin e shkollës.

Në këshillin e prindërve thirrjen e parë të Këshillit të prindërve e bën drejtori i shkollës, e pastaj mbledhjet i cakton Kryetari i këshillit.

- Konform Ligjit, Këshilli i prindërve i ka këto ingerenca:
- Jep mendim për propozim programin për zhvillimin e shkollës fillore dhe për programin vjetore për punë ;

- Diskuton për raportin për punën në shkollë;
- Propozon programe për përmirësimin e standardeve të mësimi;
- Jep pëlqim të propozimeve të drejtorit për arritjen e standardeve më të larta;
- Shqyrton ankesa të prindërve në lidhje me punën edukativo arsimore;
- Zgjedh përfaqësues për në Këshillin e shkollës fillore, dhe
- Kryen punë tjera të verifikuara me statutin e shkollës.

Detyra e përfaqësuesit të paraleles është edhe që t'i ndihmojë udhëheqësit të paraleles për realizimin e detyrave programore dhe detyrave tjera në lidhje me zhvillimin psiko-fizik të nxënësve.

Aktivitetet e Këshillit të prindërve zbatohen në përputhshmëri me Programin për punë të këtij trupi, e cila është e dhënë si shtojcë në Programin për punën e shkollës të cilën ekemi të parqitur më posht;:

Programi i punës së Këshillit të Prindërve për vitin akademik 2024/2025

Këshilli i prindërve në SHFK "Naim Frashëri" - Negotinë është i përbërë nga 64 anëtarë të cilët përfaqësojnë një përfaqësues nga çdo klasë.

Kryetar i këshillit është Rijad Bajrami. Programi i punës së Këshillit të Prindërve është si më poshtë:

Qëllimet	Përmbajtja	Realizues	Koha	Aritjet
Njohja me Programin Vjetor të shkollës	Takimet Bisedimet seminare	Prindërit Mësuesit Sh.pedagogjik	shtator	Prezantimi i punës së shkollës
Promovimi në bashkësinë e prindërve për bashkëpunim	Takimet Bisedimet seminare	Prindërit Mësuesit Sh.pedagogjik	tetor	Prezantimi i punës së shkollës
Veprimet për përmirësimin e kushteve në të cilat funksionon shkolla	Redaktimi Manifestimet Veprimet mjedisore	Prindërit Mësuesit Sh.pedagogjik	dhjetor mars prill	Gjetja e materialeve prioritare për shkollën Zhvillimi i vetëdijes mjedisore
Formimi i komisioneve dhe organeve	Trajnim në përzgjedhjen e ofruesve për: ushqime, sigurime, pikturë, udhëtime në terren dhe semimaturë	Prindërit	vazhdimisht	Pjesmarje në aktivitetet shkollore dhe përmirësimi i standardit të nxënësve

Bashkëpunim më i mirë shkollë-prindër	Takimet Bisedimet seminare	Prindërit Mësuesit Sh.pedagogjik	vazhdimisht	Komunikime cilësore në një marrëdhënie Nxënës ,mësimdhënës,prind
Informim për punën në shkollë	Raportoni para Bordit të drejtues dhe komunitetit lokal	Drejtor	shtator, nëntor janar	Informimi i plotë i prindërve dhe bashkësis lokale
Informimi i publikut të gjerë për punën e shkollës	Revista profesionale,gazetame mediumet dhe faqet zyrtare	Drfejtör Mësimdhënës	vazhdimisht	Publikimi i punëve Promovimi i arritjeve
Njoftim me projektet që realizohen në shkollë	Projektet ndëretnike dhe projekte tjera	DrejtoriMësuesit Sh,pedagogjik Prindërit, nxënësit	vazhdimisht	Pjesmarrja në krijimin e imazhit të shkollës
Ndekja e punës dhe kualiteti i aktiviteteve në bashkësin e prindërve	Takime.Bisedime, Propozime për risi dhe përmirësim të punës së shkollës	Kryetar i KP, drejtor, mësues	vazhdimisht	Pjesëmarrja në krijimin e një klime më të mirë shkollore dhe cilësinë e punës së shkollës

21.2. Përfshirje e prindërve/kujdestarëve në procesin e nxënies dhe aktivitetet jashtëshkollore

Prindërit vazhdimisht do të jenë të kyqur në procesin e mësimin me çka do të jenë të informuar për plan-programin mësimor se dhe vet procesit mësimor në disa mënyra:

- Nëpërmjet këshillit të prindërve
- Nëpërmjet takimeve individuale dhe grupore me arsimtarët
- Nëpërmjet shërbimit profesional të shkollës
- Nëpërmjet e-ditarin

Ku do t'ju jepet mundësi që të jenë të informuar në kohë që të mund të reagojnë në lidhje me suksesin dhe sjelljes e fëmijëve të tyre. Pjesëmarrja e prindërve në procesin e mësimin do të drejtohet kah dhënia e ndihmës gjatë përpunimit të mjeteve vëzhguese dhe materialeve didaktike për zhvillim me aktiv të mësimin.

Në aktivitetet shkollore

Do të merren parasysh sugjerimet nga ana e prindërve, kundrejt pjesëmarrjes nëpër manifestime të ndryshme (akcione të ndryshme në shkollë, shitje, ekspozita etj) si bashkëpunëtor në përpunimin e produkteve varësisht nga tema, promovime, si dhe vizita të institucioneve dhe objekteve të caktuara të cilat janë të lidhura ngushtë me plan-programin mësimor.

Në marrje të vendimeve

Si anëtar të organeve shkollore aktivisht do të marrin pjesë në dhënien e propozimeve në lidhje me zhvillimin e ekskursioneve, pajisje të shkollës, organizmin e prezantimeve, tribuna në tema interesante për nxënësit dhe prindërit, rregullimi i hapësirës shkollore etj.

21.3. Edukimi i prindërve/kujdestarëve

Do të organizohen punëtori edukative për prindërit në suaza të punës së këshillit të prindërve, takime me prindër dhe forma të ndryshme të punës me prindër, takime me shërbimin profesional në funksion të këshillimit të prindërve, si dhe takime individuale dhe takime në grupe të vogla me karakter edukativ.

Përpunim i broshurave për prindër

Me qëllim që prindërit më mirë të njoftohen me strukturën dhe punën e shkollës përpunohet broshurë e cila ju dhurohet prindërve dhe çdokujt të interesuar për shkollën tonë.

22.Komunikimi me opinionin dhe promovimi i shkollës fillore

- Bashkësia lokale

*Shkolla do të ketë ekskluzivisht bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale(Komuna eVrapçishtit) si themelues,posaçërisht me sektorin e arsimit. Do të mbahen mbledhje ku do të ndihmohet gjatë përgaditjes dhe realizimit të programit për punë,gjithashtu do të mbahen mbledhje të ndryshme për raste të caktuara etj. Prej këshillit të komunës së Vrapçishtit kemi dy anëtarë në Këshillin e shkollës. Do insistoahet të nënshkruhet Memorandum për bashkëpunim në nivel lokal për realizimin e programeve të përbashkëta ekologjike.

Për çdo aksion nga të gjitha sferat e mundëshme të organizuara nga ana e bashkësive vendore,shkolla jonë me nxënës dhe arsimtar gjithmon do të jetë mbrojtëse(patron)kryesor,sidomos në pjesën e fatëkeqësive natyrore(vërshimeve)dhe në pjesën e ekologjisë.

- Institucionet nga lëmia e kulturës

Nga fillimi planifikohet që të ndiqen të gjitha konkurset e shpallura dhe garat e organizuara. Gjithmonë profesorët nga lëndët e gjuhës amtare do ta marrin pjesë në konkurse të ndryshme letrare ndërsa profesorët e artit do marrin pjesë në konkurset e artit. vendet e fituara do të jenë të shpallur nxënësit së bashku me mentorët e tyre nga ana e shkollës. Nga fillimii vitit shkollor profesorët përgjegjës me nxënësit do ti vitizojnë dhe do ti organizojnë ekspozita të ndryshme,panaire për libra, vizita e përmendoreve kulturore dhe historike në data të caktuara , muzeemeve , shfaqjeve të ndryshme letrare etj.

- Institucionet nga lëmia e arsimit

Bashkëpunimi me MASH, BZHA dhe me sektorin e arsimit fillor do insistojmë që të jet në nivel. Gjithmonë do ju përgjigjena detyrave të dhëna nga pjesa e veprimtarisë edukativo-arsimore dhe statistikës.Gjithmonë inspektorët dhe këshilltarët me dashamirësi do priten dhe do u mundësojmë që pa pengesa ta kryejnë detyrën e tyre.

- Organizatat qeveritare

Nxënësit do marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme proektuese në shkollë dhe në realizimin e programeve të zgjëruara gjatë bashkëpunimit në veprimtarisë kulturore publike të komunës,përkrahje të aktiviteteve proekjtuese në bashkëpunim me organizatat joqeveritare qytetare,pjesëmarrje në ekspozita me eksponante nga puna dhe aktivitetet nga Eko- program

-Organizatat shëndetësore

Për kujdesin ndaj shëndetit dhe sigurisë së nxënësve dhe punëtorëve shkolla jonë ka një bashkëpunim të mirë me Shtëpinë e Shëndetit në Gostivar.

-Mediumet

Ne jemi të hapur dhe shkollë transparente ndaj publikut. Këtu jemi që tu përgjigjena për të gjitha dobësitë tona por edhe për rezultatet e mira nga procesi edukativo-arsimor. Bashkëpunimi gjithmonë do të jetë në nivel solid me mediumet e shkruara dhe ato elektronike siç janë GLOB, TV KOHA, ALSAT, MTV, dhe të tjera dhe me mjetet e shtypit NOVA MAKEDONIJA, VEÇER, DNEVNIK, ZHURNAL, KOHA, LAJM dhe të tjera. Shkolla ka edhe web faqen e vet. Gjithashtu do formohet ekip- person për kontakt me mediumet, ndihmës drejtori Rabi Ismaili që do ket detyrë të formon ekip dhe të organizon ndodhi dhe aktivitete nga programi ekologjik dhe promovimi i tyre para medimeve dhe publikut-fletushka shkollore.

23. Ndjekja e implementimit të programit vjetor të punës së shkollës fillore

Gjatë përcjelljes në realizimin e Programit vjetor për punën në shkollë fillon prej planit për zhvillim të shkollës, gjithashtu edhe drejtimet për vetevaluimin e punës së shkollës dhe aktet ligjore dhe joligjore në bazë të të cilave themelohet e njëjta.

Drejtori i shkollës dhe shërbimi profesional dërgojnë raport për gjysmëvjetor dhe vjetor për realizimin e programit vjetor, në bazë të raportit të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional të cilët janë përgjegjës për fusha të caktuara, dhe në bazë të pikëpamjeve personale dhe realizimit. Këto raporte shqyrtohen dhe përvetësohen nga ana e Këshillit të arsimtarëve, Këshillit të prindërve dhe Këshilli i shkollës. Kopje e raporteve dërgohet edhe të shërbimi nga sektori për arsim të themeluesit.

24. Evaluimi i programit vjetor të punës së shkollës fillore

Procesi i vlerësimit merr parasysh përvojën e të gjithë të përfshirëve në implementimin e programit vjetor të punës së shkollës fillore. Në këtë proces, vëmendje e veçantë i kushtohet mbledhjes së dëshmimeve, respektivisht të dhënat që lidhen me indikatorët ose kriteret për sukses, duke formuar konkluzione dhe rekomandime. Dëshmitë mund të mblidhen përmes: pyetësorëve, dokumenteve, procesverbaleve dhe protokolleve, diskutimeve, intervistave, njohurive mbi punën e nxënësve, procesit të vëzhgimit, raporteve të pavarura të evaluimit dhe instrumente të tjera).

25. Konkluzioni

SHFK “Naim Frasheri”, edukon dhe arsimon gjenerata që disa vite moderne, bashkëkohorë dhe shkollë efektive, lider në komunë dhe regjion, shkollë e cila është e njohur për kualitetin dhe suksesin e saj .

E nxisim zhvillimin emocional dhe social të nxënësve duke respektuar dhe karakteristikat individuale, përkatësinë etnike dhe barazinë gjinore.

Shkolla jonë e përkrah zhvillimin profesional të arsimtarëve duke siguruar kënaqësi dhe efikasitet të të gjithëve të inkuadruar në procesin edukativo arsimor.

Këtu nxënësit do të pajisen me dituri kualitative dhe afatgjate. Dituri të domosdoshme si qytetar të ardhshëm të shekullit 21.

Të punësuarit në mënyrë aktive do të kyçen në realizimin e orëve me incizim si dhe shfrytëzimin aktiv të platformave elektronike për mësim. Nëpërmjet realizimit të procesit edukativo-arsimor do të përkujdesemi që ti kënaqim dhe ti zhvillojmë interesat dhe aftësitë individuale të nxënësve, duke i inkuadruar në seksione, klube sportive të cilat i ofron shkolla dhe aktivitete të tjera jashtëmësimore.

Do ta nxisim punën e përbashkët e cila kontribuon në zhvillimin e besimin të ndërsjellë dhe shoqërim të nxënësve në kohën e lirë.

Sipas afinitet dhe aftësitë të nxënësve të tonë në mënyrë aktive do të marrin pjesë në të gjithat gara të cilat do të organizohen nga ana e komunës, qytetit, shkolla tjera, organizata joqeveritare si dhe në suaza të vet shkollës, si dhe nga ana e arsimtareve si mentorë të tyre. Me këtë do ta zhvillojmë shpirtin garues i cili do të kontribuon në afrimin e nxënësve nga mjedise të ndryshme. Nëpërmjet garave zhvillohen dhe thellohen dituritë e nxënësve. Prindërit do të jene të kyçur, duke marrë parasysh se ata ishin iniciator dhe në shumicën e rasteve ndihmuan të fillojmë me mësimin nga distanca, në procesin e mësimi të cilët do të jenë të informuar me plan-programin.

Për procesin mësimor do të informohen nga: këshilli i prindërve, takime individuale dhe grupe me arsimtarët, nga shërbimi pedagogjik i shkollës dhe nga e- ditari. Pjesëmarrja e prindërve në procesin e mësimi do të jetë e drejtuar tek dhënie e ndihmës gjatë përpunimit të mjeteve vëzhguese dhe materiale didaktike për zhvillim me kreativ të mësimi, gjatë dhënies se propozimeve në raport me pjesëmarrje nëpër manifestime të ndryshme (ekologjike, shitje, ekspozita dhe aksione humanitare në shkollë) si dhe duke ndihmuar në përpunimin e produkteve varësisht nga tema, promovime si dhe vizita të institucioneve të caktuar dhe objekte të cilët lidhen ngushtë me plan-program.

Anëtarët e këshillit të prindërve dhe anëtarët e bashkësisë së nxënësve dhe organet e shkollës në mënyrë aktive marrin pjesë duke dhënë propozime dhe sugjerime prindërit, rregullimin e oborrit dhe hapësirës së shkollës.

Shkolla do të vazhdon me bashkëpunimin e suksesshëm me mjedisin lokal, komunën, organizatat internacionale, organizatat joqeveritare nëpërmjet projekteve të ndryshme, aksione humanitare dhe aktivitete të tjera.

26. Komisioni për përpilimin e programit vjetor për punën e shkollës fillore

Ekipi që morri pjesë në përgatitjen e programit: Afërdita Hoda ,Rabi Ismaili, Lindihana Ebibi dhe mësimdhënësit tjerë nëpërmjet ideve dhe sugjerimeve për përpilimin e programës.

27. Literatura e përdorur

- Ligji për arsim dhe edukim i Republikës së Maqedonisë Veriore (Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 161/2019) Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e programit për punë në shkollat fillore nr. 14-1232/1
- Ligjet në interes për punën e shkollës si subjekt juridik, Ligji për marrëdhënie pune,
- Ligji për prokurim publik,
- Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe ligjet tjera. Aktet nënligjore të brendshme (kodi etik, Organet profesionale në shkollë, etj.)
- Rregulloret (Rregullore për punën e komisioneve, Rregullore për kujdestarinë e arsimtarëve, Rregullore për orarin e punës etj.) Plan-programet mësimore
- Koncept për shkollën fillore nëntëvjeçare Statuti i shkollës
- Programi zhvillimor 2021-2025 Vetevaluimi i shkollës 2022/23-2023/24
- Raportet vjetore (Raporti vjetor i shkollës për vitin 2023/2024)
- Raport për punën financiare të shkollës

- Data dhe nënshkrimi i drejtorit 15.08.2024 Afrdita Hoda_____
- Nënshkrimi i kryetarit të KSH Rijad Bajrami_____



